



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.5(442)

MAJ 2025

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

NDERIMI

DËSHMORËT JANË DËSHMI E ORËVE TË HISTORISË



TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU

FAQE 4

DOSSIER

RANË PËR T'U KUJTUAR NË VITE...



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

FAQE 6

PROFILI

SHPENDI TOPOLLAJI, TRIBUNA LETRARE PËR DURRËSIN



Nga Nuri BUFI

FAQE 13

Në 80-vjetorin e fitores mbi nazi-fashizmin, Shqipëria ka arsye të ndihet krenare për kontributin e saj gjatë Luftën e Dytë Botërore

80-VJETORI I LUFTËS SË DYTË BOTËRORE: SHQIPËRIA KA ARSYE TË NDIHET KRENARE

Një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor

Nga Gjeneralmajor
Manushaqe Shehu

FAQE 9



1945 – 9 MAJ – 2025 / Më 9 maj festohet 80-vjetori i fitores kundër fashizmit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, u prodhuan 650 mijë aeroplanë, 290 mijë tanke dhe 1.5 milionë gryka zjarri. Në këtë luftë morën pjesë 110 milion trupa dhe u vranë mbi 50 milion njerëz. ë të morën pjesë 110 milion trupa, që vepruan në 40 shtete ku mbi 50 milionë vetë u vranë.

FAQE 3

HALIL RAMA PROMOVON LIBRIN E 28 – TË



“Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave”

Nga Sakip Cami – Shkrimtar & publicist

Halil Rama, mjeshtër i gdhëndjes së portreteve të figurave të shquara të kombit tonë

FAQE 9

Nga Tatjana Parllaku-Çarkaxhiu

Homazh për Fatbardh Musabelliun

Nga Zef RROZHANI

FAQE 12

IN MEMORIAM

Forcat Ajrore Shqiptare u krijuan
zyrtarisht me 24 prill 1951

HISTORIKU I ARMËS SË AVIACIONIT LUFTARAK

Nga Gjin MUSA

FAQE 5

IN MEMORIAM

Vrasja më e madhe e shqiptarëve gjatë luftës në
Kosovë, ndërsa kriminelët s'u dënuan kurrë

NË MASAKRËN E MEJËS U VRANË 376 SHQIPTARË

Nga Bashkim Hisari

FAQE 10

SKICË

HAKI UKA NË NJË PORTRETIZIM TË VEÇANTË

Nga Agim Golemi

FAQE 11

SUPLEMENTI LETRAT

HOXHË BRUNGA I LURËS, EMBLEMË SHQIPTARIE

MEVLUD BUCI

FAQE 12

SUPEMENTI LETRAT

Ja pse më gëzon fakti i promovimit të librave të shkrimtarit Halil Rama

Prof. dr. Fatmir TERZIU

FAQE 14

PESHA SPECIFIKE E PERSONAZHEVE TË HALIL RAMËS

BESIM NDRËGJONI

FAQE 15

DOSSIER

Në 80-vjetorin e fitores mbi nazi-fashizmin, Shqipëria ka arsye të ndihet krenare për kontributin e saj gjatë Luftës së Dytë Botërore

80-vjetori i Luftës së Dytë Botërore: Shqipëria ka arsye të ndihet krenare

Në 80-vjetorin e fitores mbi nazi-fashizmin, Shqipëria ka arsye të ndihet krenare për kontributin e saj gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe që prej 16 vitesh është e përkushtuar si anëtare e NATO. Të angazhuar për të përmbushur të gjitha detyrimet për të qenë sa më parë edhe anëtarë të BE.

Më 9 maj të këtij viti mbarë njerëzimi përparimtar botëror, feston 80-vjetorin e fitores kundër fashizmit. Në emër të lir-

1945 – 9 MAJ – 2025 / Më 9 maj festohet 80-vjetori i fitores kundër fashizmit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, u prodhuan 650 mijë aeroplanë, 290 mijë tanke dhe 1.5 milionë gryka zjarri. Në këtë luftë morën pjesë 110 milion trupa dhe u vranë mbi 50 milion njerëz.

Në të morën pjesë 110 milion trupa, që vepruan në 40 shtete ku mbi 50 milionë vetë u vranë.

e ALV, pothuajse 1,5 milionë gryka zjarri (topa e mortaja BQ), dëshmon për atë bazë të fuqishme të industrisë ush-



tarake, që pati me të vërtetë kjo ndeshje gjigante, e pa krahasuar në historinë e njerëzimit. Nga ana tjetër, ato tregojnë se ç'burime të mëdha materialo-teknike, krijuese, shkencore, janë sakrifikuar për faj të shkaktarëve të kësaj lufte. Popujt lirishtashës e paqedashës në të katër anët e botës, së bashku me ta edhe populli ynë, festojnë me krenari ditën e fitores mbi nazi-fashizmin. Ajo ishte një fitore e mëdha e mbarë njerëzimit e cila u arrit me gjak e sakrificë të shumta. Kohët ndrysho-

isë e pavarësisë kombëtare, në emër të demokracisë e të përparimit, popujt që luftuan kundër nazi-fashizmit, bashkë me ta edhe populli shqiptar, derdhën shumë gjak dhe përballuan shumë vështirësi, mundime e vuajtje. Lufta e Dytë Botërore, ishte ndeshja më e madhe ushtarake në historinë e pafund të luftërave, që e kanë zanafillën e tyre, që kurse shoqëria njerëzore u nda klasa antagonistë, në shtypës e të shtypur, në shfrytëzues e të shfrytëzuar. Nga 14 500 e më shumë luftëra që kanë llogaritur historianët, që nga antikiteti deri më sot, ku kanë gjetur vdekjen pothuajse aq njerëz, sa ka bota sot banorë. Lufta e Dytë Botërore dallohet për shtrirjen e saj shumë të gjerë, në shkallë botërore, për teknikën e lartë të armatimit dhe sasinë jashtëzakonisht të madhe. Ajo tërhoqi në orbitën e saj 61 shtete, me një popullsi rreth 1 miliard e 700 milionë njerëz, e barabartë me 80 për qind të popullsisë së botës. Në të morën pjesë 110 milion trupa, të mobilizuar, që zhvilluan veprime e tyre luftarake në teritorët e 40 shteteve dhe mbi 50 milionë vetë u vranë në front e në prapavijë, prej të cilëve 26 milionë ushtarak dhe 24 milionë nga popullsia civile.

Ajo gëlltiti mjete financiare kolosale Shpenzimet ushtarake dhe humbjet gjatë 6 vjetëve të zhvillimit të saj e kalonin shumën fantastike të 14 mijë miliardë dollarëve. Prodhimi gjatë viteve të Luftës së Dytë botërore, vetëm nga SHBA, BS, Anglia dhe Gjermania, të mbi 650 mijë aeroplanëve dhe të afro 290 mijë tankeve



popujt e mbarë botës sepse ato i hapën rrugën e demokracisë e njerëzimit. Lufta e Dytë botërore ishte një provë e madhe për të gjithë popujt dhe shtetet e forcat politike. Në flakët e kësaj lufte u vlerësuan dhe u provuan jo vetëm fuqitë ushtarake të shteteve pjesëmarrëse por edhe vlerat morale të popujve. Në një plan të përgjithshëm nuk mund të kuptohet në thellësi bota e sotme, raportet e forcave brenda saj, aleancat dhe konfliktet e hapura e të maskuara në të, sistemet politike dhe ekonomike, financiare, grupimet politike e ushtarake, sidomos në kontinentin evropian pa njohur zhvillimet e pasojat që shkaktoi Lufta e Dytë Botërore, pa zbërthyer ato mekanizma të brendshme, që çuan në shpërthimin e saj dhe në atë fund logjik të këtij konflikti të përbotshëm.

Si çdo fenomen tjetër shoqëror, Lufta e Dytë Botërore u përgatit dhe pati një periudhë të saj " të inkubacionit ". Rrënjët e saj i gjejmë në krizën e përgjithshme të viteve 1930 (dhjetëra milionë të pa punë të vitit 1931 paralajmëronin dhjetëra milionë viktima të luftës BQ), në lindjen e regjimeve fashiste në Itali, Gjermani dhe Japoni, në politikën e lëshimeve të fuqive imperialiste ndaj fashizmit, në synimet e tyre agresive ndaj vendit të parë socialist në botë BS (sot Rusia BQ). Vetë shpërthimi i luftës ishte në vetvete një revansh i forcave të errësirës, mbi popujt, lirinë e tyre, mbi ideat më të larta e më të çmuar të njerëzimit. Prandaj njohja e faktorëve, që çuan në këtë luftë të përbotshme, mbetet edhe sot temë e hapur e me vlera mjaftë aktuale. Ato duhet njohur jo si kuriozitet, por që të nxirren më-

Por ka edhe një arsye tjetër Në qoftë se shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore ishte revanshi i forcave të errësirës, fundi logjik i saj ishte në vetvete triumfi i idealeve të lirisë, pavarësisë, përparimit kombëtar e shoqëror të popujve në mbarë botën, të cilët ishin edhe fitimtarët e Luftës së Dytë Botërore. Njohja e kësaj lufte të popujve, e kësaj fitoreje të tyre ndaj bishës nazi-fashiste, është burim krenarie e optimizmi revolucionar, që forcon besimin në të ardhmen, për fuqinë e pathyeshme që kanë popujt për të mbijetuar përballë çdo rrebeshi të historisë. Për ne shqiptarët, si një popull i vogël, i copëtuar disa herë e i nëpërkëmbur vazhdimisht e që kësaj here rrezikohej të humbiste krahas lirisë edhe pavarësisë së atdheut edhe vetë qenien e tij si popull e si komb. Lufta përbente një barrë të rëndë e një provë të vështirë, që kërkonte jo vetëm guxim e trimëri për të përballuar privacione të shumta, të cilat nuk i kishin munguar edhe më parë, por mbi të gjitha pjekuri e aftësi për t'u orientuar drejt e për të zgjedhur rrugën që duhej ndjekur, për të realizuar aspiratat kombëtare, për të ndërmarrë ato vendime e për të kryer ato veprime që do ta renditnin në një rradhë me forcat demokratike e përparimtare të kohës. Sot mbas 80 vjetësh, nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, kur rezultatet e përfundimit e saj kanë qenë objekt studimesh e analizash të shumta, të studiuesve tanë e të huaj, mund të thuhet me plotë gojën, se populli shqiptar e kaloi me sukses këtë provë të vështirë të historisë, duke qëndruar me dinjitet dhe krenari, në një rradhë me popujt përparimtar e lirishtashës që kontribuan në fitoren mbi fashizmin. Dhe merita për këtë i takon në radhë të parë popullit shqiptar, por edhe Partisë Komuniste, Frontit Nacionalçlirimtar dhe Ushtrisë, të vetmet forca që i dolën për zotë atdheut në momentet më kritike, që po kalonte vendi dhe bota, që e rreshtuan popullin tonë në Koalicionin Antifashist përkrah aleatëve të mëdhenj dhe popujve të tjerë lirishtashës dhe e udhëhoqën atë në luftën më të vështirë e më të përgjakshme, por edhe më e lavdishme e më fitimtare në historinë e tij.

Shqipëria u bë viktima e parë e agresionit fashist në Ballkan Megjithëse në kushtet të vështira, ai u tradhtua edhe nga mbreti Zog dhe regjimi i tij i kalbur, i mbetur i vetëm dhe pa përkrahje nga jashtë, populli shqiptar i priti me pushkë në dorë agresorët fashist Italian dhe më pas edhe atë gjerman duke treguar edhe njëherë shpirtin e papërkulur e lirishtashës të tij. Në këtë mënyrë ai u radhit i pari në Ballkan e në

sime për sot e të ardhmen, për të patur një vizion më të gjerë rreth zhvillimeve të fenomeneve të kohës sotme. Është kjo arsyeja tjetër që e mbanë kurdoherë të ndezur interesin mbi Luftën e dytë Botërore.

(Vijon në faqen 3)

DOSSIER

Në 80-vjetorin e fitores mbi nazi-fashizmin, Shqipëria ka arsye të ndihet krenare për kontributin e saj gjatë Luftës së Dytë Botërore

80-vjetori i Luftës së Dytë Botërore: Shqipëria ka arsye të ndihet krenare

(Vijon nga faqja 2)

Europë, që e nisi luftën më armë në dorë, kundër pushtuesve fashist, pa filluar ende Lufta e Dytë Botërore dhe pa u krijuar Koalicioni Antifashist dhe Aleanca tri palëshe anglo – sovjet – amerikane. Populli shqiptar nuk priti, që lirinë t'ia sillnin si dhuratë të gatshme të tjerët, nuk priti gjithashtu derisa pesha e luftës të anonte nga koalicioni antifashist, pastaj të përcaktonte qëndrimin e tij ndaj agresionit fashist. Rezistenca e nisur më 7 prill 1939, u ngrit në një shkallë cilësisht më të lartë, me krijimin e PKSH dhe formimin e Frontit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë në shtator 1942. Nën drejtimin e tyre ajo u shndërrua në një luftë mbarë popullore, krijoi ushtrinë nacionalçlirimtare, me një strategji të qartë e organizim të shëndosh, në të cilën u përfshin shtesa të gjëra shoqërore dhe patriot të njohur e me autoritet në të gjitha krahinat e vendit. Në këtë proces u formua UNÇSH-ja, që në fund të luftës do të numëronte 70 mijë luftëtar në radhët e saj, bija e bijë, më të mirët e popullit tonë, të rreshtuara në batalione, brigada, divizione dhe korparmata. Në zjarrin e kësaj lufte, u sigurua bashkimi i mbarë popullit shqiptar pa dallim bindjeje, feje, krahine e ideje, rreth një ideali të madh e të shenjtë, çlirimit të vendit nga okupatorët nazi-fashist. Me një përbërje të tillë gjithë përfshirëse e të bashkuar rreth Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, që do të bëhej faktori vendimtar i bashkimit, i organizimit e i mobilizimit të masave popullore në luftën kundër pushtuesit. Gjë që mundësoi çuarjen e luftës së popullit tonë në fitoren përfundimtare më 29 nëntor 1944, çlirimin e Shqipërisë me forcat e veta.

Lufta nacionalçlirimtare ishte pjesë përbërëse e rezistencës europiane. Lidhjen dhe bashkëveprimin me vendet e tjera në kuadrin e Koalicionit Antifashist Botëror, LANÇ-i nuk e konceptoi si një aderim apo si një solidarizim i thjeshtë, por si një angazhim total të politikës e të strategjisë së tij, të mobilizimi të të gjitha forcave e mjeteve që dispononte për shkatërrimin përfundimtar të bishës naziste duke bashkëpunuar krah për krahë me popujt e vendet e tjera. Në territorin e Shqipërisë pushtuesit nazi-fashist



përqendruan 15 divizione me rreth 700 mijë trupa, të cilët pësuan një humbje me rreth 70 mijë trupa.

Sakrificat që bëri dhe gjaku që derdhi populli ynë, në luftën për çlirimin e vendit, dhe për kauzën e përbashkët të popujve të tjerë, për shkatërrimin e bishës nazifashiste, në raport me popullsinë, janë shumë të mëdha, 28 mijë dëshmorë, bija dhe bijë dhanë jetën e tyre në këtë luftë të pa barabartë, si në forca dhe në mjete. Krahina të tëra u dogjën e u shkatëruan, fshatar e qytete u rrënuan. E tërë pasuria kombëtare që brezat e mëparshëm, kishin mundur të grumbullonin u shkatërrua dhe u rrëmbye nga pushtuesit. Të llogaritura për frymë të popullsisë, Shqipëria zë një nga vendet e para, për dëmet materiale të pësuar gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Përkujtimi i 9 majit

Përkujtimi i 9 majit nuk është thjeshtë një homazh që u bëhet popujve që luftuan e i kontribuuan fitores mbi nazi-fashizmin. Kjo datë e shënuar, në situatat që po kalojmë, ka marrë një dimension më të plotë e vjen si një kujtesë e si një mesazh për popujt dhe politikën, për të mos haruar e për të mbajtur kurdoherë, parasysh ata faktorë që çuan e mund të çojnë, rishtas në vendosjen e fashizmit e diktaturave fashiste në vende të ndryshme të Europës. Premisat janë.. E për rrjedhojë duhet të merren masa që realisht t'u pritët rruga e nuk u duhet lënë fare hapësirë e mundësi gjallërimit e aktivizimit të forcave fashiste e neofashiste në Shqipëri. Edhe sot pas 80 vjetësh ndryshime të thella, popujt janë të ndeshëm e të shqetësuar për dukurit e fenomenet me prirje e tendenca fashiste e neofashiste, që herë pas herë ngrënë krye në vende e rrethana të caktuara, duke rrezikuar stabilitetin, demokracinë dhe prosperitetin e njerëzimit. Një analizë e gjithanshme historike këtij problemi, tregon se fashizmi si rrymë politike, nuk është një fenomen abstrakt e i rastit; ai nuk lind në një terren bosh e brenda një nate apo muaji. Atë e përgatitin dhe e sjellin në fuqi faktorë të shumtë, politik, ekonomike e shoqëror të brendshëm e të jashtëm. Historia tashmë ka treguar e provuar se dalja në skenën politike të grupeve të caktuara shoqërore, të dëmshme e të etshëm e të papërmbytura për pushtet e për pasurim në kurriz të masave punonjëse e duke shfrytëzuar mundin e djersën e tyre, bëjnë premtime të bujshme për të marrë pushtetin dhe me marrjen e tij, masat punonjëse shpejt zhgënjehen si pasojë e mos mbajtjes së

premtimeve dhe krizës së rëndë ekonomike e shoqëruar me papunësi masive e rënies drastike të nivelit të jetesës së popullit dhe polarizimit të shpejt e të tej skajshëm e dallimit të thellë në jetën e tij shoqërore, me lulëzimin e korrupsionit, të kriminit të organizuar e të mafies në sektorë e fusha të ndryshme, mohimi e shkelja e të drejtave të qytetarëve, denigrimi i kundërshtarëve politik etj, janë disa nga faktorët që favorizojnë e shpejtojnë lindjen dhe ardhjen e fashizmit në fuqi.

Në klimën e sotme demokratike e pluraliste pas viteve 90, kanë ngjallur neveri e urrejtje, përpjekjet dhe veprimet për rehabilitimin e nderimin e kolaboracionistëve dhe bashkëpunëtorëve të fashizmit, vetëm e vetëm, se ishin kundër komunistëve, sot u japin dekorata dhe u ngrenë përmendore, por harrojnë se ata i kishin të lyera duart me gjakun e shtrenjtë të partizaneve, bijave e bijve më të mirë të popullit shqiptarë, të cilët si idealist që ishin rrëmbyen armët dhe luftuan për çlirimin e vendit nga nazi-fashizmi.

Mujo Ulqinaku "Hero i Popullit", në ditarin e tij, kur po sulmohej vendi, shkruan: "Tradhtia e ka mbuluar vendin tonë. Neve na takon të luftojmë për të mbrojtur lirinë e pavarësinë. Të betohemi vëllezër, se s'do të kursejmë, as jetën tonë për mbrojtjen e atdheut." Për ata faktorë dhe ato forca që i hapën rrugën hipjes së fashizmit në pushtet, qëndron thënia e B.Brehtit, që thotë " barku që polli fashizmin akoma nuk është shterpëzuar." Ndërsa çeku Julius Fuçiku thotë :-" Njerëz ju dua, jini vigjilent."



NDERIMI

Jeta, vepra dhe rënia e tyre përcjellen si mësim dhe frymëzime ndër breza

Dëshmorët janë dëshmi e orëve të historisë

TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU

5Maji është një datë e rëndësishme historike për shqiptarët, pasi përkujtohen Dëshmorët e Kombit.

Në Ditën e Dëshmorëve të Kombit janë të shumtë emrat e të gjitha kohërave që kujtohen me mirënjohje jo vetëm për vlerat e përjetshme dhe kontributin që dhanë për çlirimin e vendit për një të ardhme më të mirë, por edhe të gjithë ata që sakrifkuan jetën e tyre për liri, demokraci, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e çdo shqiptari.

Dëshmorët janë dëshmi e orëve të historisë, dëshmitarë të historisë së kombit. Jeta, vepra dhe rënia e tyre përcjellen si mësim dhe frymëzime ndër breza.

Çmimi i lirisë është paguar me gjakun e dëshmorëve, andaj jeta e tyre është e paçmueshme në të gjitha kohët.

Dëshmorët janë të vetmit që e kanë përfunduar dhe vulosur angazhimin e tyre për vendin, për lirinë dhe për atdheun. Ne të gjallët e sotëm dhe të brezave pasardhës, e kemi për detyrë të përditshme angazhimin dhe përpjekjen për atdheun, për lirinë dhe për vendin.

Dita e Dëshmorëve e ka origjinën në 5 Maj 1942, kur u vra Qemal Stafa, i cili me veprimtarinë e tij u kthye në simbol të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në nderim të kujtimit të të rënëve për lirinë e vendit, çdo vit në Varrezat e Dëshmorëve kërret më të lartë të shtetit shqiptar, veteran të LANÇ e pasardhës të tyre kryejnë homazhe.

Përpara krijimit të shtetit shqiptar, populli i kujtonte dëshmorët dhe mban te gjallë legjendat e tyre, nëpërmes këngës epike, dhe trashëgimisë të historisë të tyre nga brezi në brez.

Pas shpalljes së Pavarësisë më 1912 e deri me 1945, shteti shqiptar nuk krijoi një status ligjor për dëshmorët e Atdheut. Gjatë luftës Nacionalçlirimtare, nisen përpjekjet e para, për të nderuar dëshmorët e rënë në fushat e betejave. Pas çlirimit, më 28 gusht 1945, kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, miratoi ligjin Nr. 109 "Mbi shpërblimin e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare". Ky ligj sanksiononte trajtimin e familjeve të patriotëve që kishin luftuar e rënë për atdheun edhe para Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në kohën e Rilindjes Kombëtare, në luftërat për pavarësi, duke shënuar kështu përpjekjen e parë për një ligj integral për dëshmorët e Atdheut.

Në vitet '60-të statusi i dëshmorit përpunohet më tej dhe zgjerohet, duke specifikuar termin "Dëshmor i Atdheut". Në këtë ligj futen edhe Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, të cilat u ndëruan në të gjitha qendrat e rretheve të vendit. Me 1992-1993, me ndërrimin e



sistemit politik, pësoi ndryshime edhe statusi i Dëshmorit të Atdheut.

Në vitin 2000, pas shumë përpjekjeve u miratua ligji Nr. 8607 datë 27.04, "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", në të cilin përfshihen dëshmorët e të gjitha periudhave historike, madje edhe të rënë në vitet 1997-1999, në Shqipëri dhe në Luftën Çlirimtare të Kosovës.

NDERIMI I DËSHMORËVE, NDERIM PËR HISTORINË

Në 5 maj i gjithë Atdheu mban frymën në respekt të pafund për të rënë për atdheun, martirët e kombit që sakrifkuan jetën e tyre e në emër të Shqipërisë. Lufta për çlirimin e atdheut gjaku i derdhur, jetët e flijuar dhe sakrificat sublime për lirinë e tij, janë gdhendur si dëshmia monumentale e një populli që ka luftuar në mënyrë të paepur me pushtuesit gjatë gjithë historisë së tij. Nderimi ndaj dëshmorëve, është nderim për historinë e popullit, por është edhe një referencë krenarie, që na frymëzon për ta mbajtur të shenjtë amanetin e tyre, Shqipërinë e lirë, shtëpinë tonë të përbashkët!

Veteranët e LANÇ, familjet e tyre, pasardhësit dhe gjithë shqiptarët e ndershëm e patriotë nderojnë në këtë ditë gjakun e 28 mijë yjeve të pashuara.

Bota e qytetëruar, shoqëritë e rritura përmes vlerave, ku janë kultivuar parime themelore në ecurinë e brezave, mes të tjerash, e kanë mësuar kombin të kthejë rregullisht kokën mbrapa e të shohë rrugën e përshkuar, të dijë nga vjen, të kujtojë e respektojë historinë e të parëve dhe të mësojë prej asaj kohe se ku do shkojë. Është kjo arsyeja që pothuaj gjithë shtetet e kombet kanë një ditë në vit që përkujtojnë heronjtë, dëshmorët, të rënë në betejat për atdheun, për kombin.

Disa e quajnë "Dita e Heronjve", disa të tjerë "Dita e Heronjve Kombëtarë" ose "Dita e Martirëve". Ne e quajmë "Dita

e Dëshmorëve të Atdheut" dhe pasi Republika e Kosovës e përshtati këtë ditë përkujtimore, 5 Majin, edhe për bijtë e bijat e saj të rënë për lirinë, u mësua ta quajmë "Dita e Dëshmorëve të Kombit".



Më 5 Maj, në Ditën e Dëshmorëve të Atdheut, veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe pasardhësit e denjë të tyre do të bëjnë homazhe në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit, në nderim të të gjithë të rënëve për liri dhe do të vendosin kurora me lule pranë Monumentit "Nënë Shqipëri". Në këtë ditë i mbarë kombi përulet me nderimin më të thellë ndaj veprës së pavdekshme të martirëve të lirisë, gjithë të rënëve të kombit, të cilët vendosën jetën e tyre, rininë e tyre në themelet e lirisë së sotme, të cilët me sakrificën e tyre u bëjnë dritë gjithë shqiptarëve në rrugën e lirisë, në rrugën e demokracisë, në rrugën e integritetit. Ëndrra e atyre që ranë për atdheun ishte liria dhe sakri-

fica e tyre, ishte ndër më të çmuarat që ka njeriu, ishte sakrificë për lirinë dhe vlerat e saj. Në këtë ditë solemne shqiptarët vlerësojnë jetën dhe kontributin e 28 mijë yjeve të pashuara, të të gjithë të rënëve për lirinë e vendit. Më 5 Maj të gjithë qytetarët e këtij vendi përulet me nderimin më të thellë për veprën e të gjithë atyre që vendosën sakriA cën e tyre sublime në themelet e lirisë. Shpirti i tyre, sakrificat e tyre, është dritë për rrugën e lirisë, është nder i madh për të gjithë familjarët e të rënëve, sepse të gjithë e duan lirinë, por ata kanë bërë sakrificën më të madhe, sakrificën më sublime. Çdo ditë dhe çdo kohë që kalon, çdo përparim që bëhet në rrugën e lirisë, shton nderin për të rënë të kombit, shton nderin për familjet e tyre. Veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ndjehen më krenarë se kurrë në këtë ditë të shënuar pasi shohin të realizuar ëndrën e bashkëlufetarëve të tyre, të Qemalit, Vasilit, Margaritës e mijëra të tjerëve, për një Shqipëri të lirë e demokratike, shohin të realizuar qëllimin e përbashkët: Kosovën e lirë e të pavarur që përparon drejt shtetit të saj demokratik modern. Këtë 5 Maj kujtojmë me nderim ata emra që janë

shkruar në lavdinë e kohës; në faqet e historisë, në zemrat e brezave të kësaj toke..., emra që rrezatojnë dritë diturie, dritë lirie. Ata u dhanë brezave dituri, ata nuk kursyen as gjënë më të çmuar, jetën ndaj kurdoherë do mbeten në altar të lirisë, në kujtime, në këngë.

Toka dhe historia sikur i bleron dëshmorët, sikur i lartëson, sepse e blertë, e lartë, e përjetshme është vepra e tyre. Si çdo vit tjetër edhe këtë 5 Maj Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare do të organizojë homazhe në Varrezat e Dëshmorëve dhe vizita në familjet e tyre. Nderojmë kështu luftën dhe sakrificat e tyre, nderojmë gjakun e derdhur për lirinë e Atdheut tonë të shtrenjtë.

IN MEMORIAM

Forcat Ajrore Shqiptare u krijuan zyrtarisht me 24 prill 1951



Nga Gjin MUSA

Shteti shqiptar bëri përpjekje të shumta për krijimin e armës së aviacionit luftarak, por për arsye politike një gjë e tillë nuk u arrit dot deri mbas Luftës së Dytë Botërore.

Në vitin 1945 një grup ish-partizanësh filloi përgatitjen për pilotë luftarakë në shkollën e aviacionit jugosllav. Ky grup përbëhej nga Niko Hoxha, Edip Ohri, Fahri Bubësi, Pertef Myftari, Ibish Vokshi, Zyhdi Rada, Sazan Xhelo, Irakli Grazhdani, Masar Aga, etj.

Pas prishjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, grupi e vazhdoi përgatitjen në Bashkimin Sovjetik.

Forcat Ajrore Shqiptare u krijuan zyrtarisht me 24 prill 1951. Avionët e parë ishin avionë sovjetikë të prodhuar mbas Luftës së Dytë Botërore Yak-18 dhe fillimisht u dislokuan në Laprakë në periferi të kryeqytetit të Shqipërisë, Tirana.

Pak vite më vonë, Forcat Ajrore Shqiptare do të pajiseshin edhe me avionë luftarakë reaktive. Skuadrilja e parë me avionë luftarakë MiG-15Bis, kodi i NATOs 'Fagot' e titulluar "Peza" u krijua në vitin 1955. Kjo skuadrilje u dislokua në aeroportin e Kuçoves.

Në vitet e mëvonshme, në kuadrin e ndihmës ushtarake nga Bashkimi Sovjetik, Forcat Ajrore Shqiptare do të pajisen edhe me avionë luftarakë të tipeve MiG-17, kodi i NATOs 'Fresco' dhe MiG-19, kodi i NATOs 'Farmer', dhe në fillim të viteve 70-të edhe me avionë luftarakë MiG-21 të prodhimit kinez.

Avionët luftarakë që erdhën nga Kina kishin marka prodhimi të ndryshme nga ata sovjetikë, por në Forcat Ajrore Shqiptare, ata u njohën gjithmonë me markën sovjetike të prodhimit. Në qershor 1957 u krijua regjimenti i parë transportues i pajisur me helikopterë Mi-1 (3 copë), helikopterë të rinj Mi-4 (3 copë) si edhe disa avionë me helikë Yak-18 dhe PO-2. Në vitin 1967 ky regjiment u zgjerua në kapacitetet me ardhjen e 30 helikopterëve Mi-4.

DËSHMORËT QË RANË NË KRYE TË DETYRËS

Forcat Ajrore Shqiptare janë një forcë me një histori shumë krenare.

Historiku i armës së aviacionit luftarak

• Forcat Ajrore Shqiptare janë një forcë me një histori shumë krenare. Lista e dëshmoreve është fatkeqësisht e gjatë por është e rëndësishme që ata pilotë që flijuan jetën e tyre për atdheun, të mos harrohen

Lista e dëshmoreve është fatkeqësisht e gjatë por është e rëndësishme që ata pilotë që flijuan jetën e tyre për atdheun, të mos harrohen.

Pilotët që ranë në krye të detyrës

- Vasil Nikollë Trasha
- Hektor Eftim Lako
- Sokrat Gori Basha
- Niko Selman Hoxha
- Stilian Vani Tanku
- Jovan Kacorri
- Muharrem Murat Hida
- Refit Asllan Jazo
- Kaso Salo Petoshati
- Shyqyri Aziz Balla
- Hazbi Ramadan Serani
- Islam Mani
- Bego Isa Hoxha
- Dhimitër Spiri Robo
- Veiz Halil Kovaçi
- Sefedin Hasan Tomçini
- Vasil Thoma Noni
- Shpëtim Selman Sula
- Armando Liman Gjoka
- Sabri Shefki Toçi
- Luto Refat Sadikaj
- Ndue Mëhill Logu
- Haki Abaz Skuqi
- Jorgji Fane
- Agron Hasan Galanxhi
- Enver Osman Haka
- Pandeli Jorgo Zhupa
- Tafil Njazi Agai
- Vangjel Vangjel Postoli
- Veleidin Delo Resuli
- Eduard Qiriako Kostëdhima
- Fluturim Qani Molla
- Idriz Ibrahim Hoxha
- Jani Tarifa
- Ibish Vokshi, vrarë në Jugosllavi
- Qemal Mërtiri, vrarë në Rusi



MiG-17



MiG-19

- Vangjel Çondi, pilot i helikopterit Bell 222U i rrezuar në detin Adriatik
- Qemal Koni, inxhinier i helikopterit Bell 222U
- Demush Heba, pilot i he-



MiG-21

DOSSIER

RANË PËR T'U KUJTUAR NË VITE...

(Në kuadrin e 80 vjetorit të rënies së dëshmorë të BrXXVS)



Ranë për t'u kujtuar në vite...



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

LUFTOI NGA SHIJAKU NË KOSOVË

Bahri H. Shaqiri lindi në Shijak më 22 prill 1922. Aty kreu dhe shkollën fillore. Studimet i vazh-

doi në Shkodër, në Tiranë në gjimnaz më 1938, ku u njoh me Qemal Stafën, Manush Alimanin etj. Ishte djalë shtatgjatë e truphollë, me sy të zjarrtë e të qeshur, kishte temperament të gjallë, merrte pjesë në lojerat sportive dhe aktivitetet kulturore-artistike që zhvilloheshin në shkolla, i binte bukur violinës dhe shkruante vargje.

Në Shijak u lidh me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare, ku si agjikator, shpërndarës i shtypit të Partisë, pjesëmarrës me guerillasit për prerjen e telave telefonike në korrik 1942, spikati kudo gjakftohtësia, guximi dhe gatishmëria për të bërë çdo sakrificë për çështjen e lirisë së atdheut.

Veprimtaria e tij ra në sy të armikut dhe më 5 korrik 1943 hidhet në rreshtat partizane në forcat e Pezës, në çetën që vepronte në zonën e Shijakut, ku zgjidhet përgjegjës i rinisë në çetë. Në batalionin e parë të Grupit të Pezës, Bahriu u caktua komisar politik kompanie, ku mori pjesë në luftimet në Karpën e në

Pezën e Vogël. Në dhjetor 1943 kaloi me detyrë pranë shtabit të Grupit Partizan të Pezës.

Në fund të dhjetorit 1943 Bahri Shaqiri u dërgua me detyrë partie në Kosovë. Aty për 10 muaj bëri një punë të madhe me rininë shkollore e me rininë punonjëse në Prishtinë e në Gjakovë.

Në tetor-nëntor 1944 forcat e DVS të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, në bashkëpunim me forcat partizane vendase, zhvilluan luftime të ashpra kundër forcave hitleriane e tradhtare në Kosovë. Brigadat shqiptare e ndoqën këmba-këmbës armikun gjatë muajit dhjetor 1944.

Në një nga luftimet që zhvilloi kundër armiqve, batalioni ku bënte pjesë Bahriu, u gjend i rrethuar. Duke çarë rrethimin, Bahriu as u tremb, as u tërhoq dhe e vazhdoi luftimin... po nuk kaloi shumë dhe u godit për vdekje.

Populli kosovar i bëri nderimet e merituar birit që dha jetën për çlirimin e tij. Eshtrat e tij në vitin

1976 u prunë në Tiranë dhe janë vendosur në varret e dëshmorëve.

JA ZBARDHE FAQEN PLAKUT...

Hasan Hysen Bardhoshi ishte nga fshati Qarr i Krumës së Hasit të Thatë, i lindur në vitin 1920. Shumë kujtime të sjell ky vend. Malet që e rrethojnë në shekuj kanë shërbyer si çerdhe të luftëtarëve të lirise dhe të pavarësisë. Nga fshati Qarr qenë nisur forcat e Bajram Currit në maj të vitit 1924 për të sulmuar qendrën e prefekturës së Kosovës, Krumën. Në luftimet që u zhvilluan për marrjen e Krumës e deri në Kala të Dodës, krah për krah me Bajram Currin mori pjesë dhe i ati i Hasanit, Hyseni, i cili e pat shoqëruar plakun e maleve në çdo betejë. Hasani i vogël, u rrit me jehonën e krismave të armëve në ato vite të stuhishme... Shkollën fillore e kreu në fshatin Golaj, pastaj vazhdoi mësimet në internatin "Koso-

(Vijon në faqen 7)

DOSSIER

Ranë për t'u kujtuar në vite...

(Vijon nga faqja 6)

va” të Krumës dhe në gjimnazin e qytetit të Shkodrës. Këtu Hasani u njoh me gjimnazistë dhe me idetë revolucionare, si me Emin Durakun, Nazmi Rushitin etj. Hasani u aktivizua dhe shpejt veprimtaria e tij ra në sy të autoriteteve, të cilët e përjashtuan nga shkolla. Ai u kthye në Qarr dhe kapi shatin për të punuar si bujk pa e ndërprerë asnjë çast veprimtarinë e tij revolucionare. Kështu në krahinën e largët dhe të izoluar të Hasit, punoi me ngulm në dobi të Luftës Nacionalçlirimtare. Hasani ishte një nga partizanët e parë të asaj krahine që hodhi pushkën krahut dhe doli malit për liri. Me formimin e BrXXVS, ai u radhit në rreshtat e saj dhe në të gjitha luftimet u shqua për trimëri të rrallë. Për këto merita shtabi i brigadës e caktoi atë zëvendëskomandant batalioni, për anën ekonomike, detyrë të cilën e kreu deri në fund. Çlirimi i vendit tonë nga pushtuesit nazistë dhe tradhtarët e vendit, për të cilin ëndërronte gjithnjë Hasani, e gjeti atë jashtë kufijve të atdheut duke luftuar në Kosovë dhe në tokat e Jugosllavisë. Ai mori pjesë në të gjitha luftimet e ashpra që zhvilluan partizanët e BrXXVS si në Kosovë, Ferizaj, Pripolje e deri në Sanxhak.

...Ishte janari i vitit 1945. Bënte ftohtë dhe acar i madh. Dëborë e kalonte metrin, megjithatë partizanët çanin përpara. Së bashku me ta luftonte edhe Hasani, i cili sulej me furi duke lëshuar me pushkën e tij plumba mbi kokat e armikut. Në ato ditë të janarit në Sanxhakun malor u zhvilluan shumë luftime, të cilat u kurorëzuan me sukses nga partizanët tanë trima. Në këto luftime të ashpra ra me armë në dorë partizani Hasan Qarri.

Gazeta e xhepit e BrXXVS “Luftëtari i malësisë” shkroi: “Një predhë gjakatare vërshtëlleu dhe krisma e saj ushtoi në grykat e Sanxhakut të mbulue me dëborë. Trupin e partizanit Hasan Hyseini Qarri e kishin dërmue copat e murtajës... Ja edhe një martir i ri. Hasani ra dëshmor në fushën e betejës, këtu në tokat e Sanxhakut, larg atdheut”. Kur i shkoi lajmi nënës së Hasanit për vrasjen e të birit, ajo ligjëroi: “Ti ja zbardhe faqen Plakut, / Ylli i kuq me pika të gjakut...”. Është shpallur Dëshmor i Atdheut më vendim nr. 104, datë 13.11.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tropojë.

KUDO LUFTOI ME TRIMËRI
Mushak Kadri Rustemaj kishte

lindur në vitin 1921 në fshatin Koçanaj të rrethit të Tropojës. Shkollën fillore e kreu në fshatin Kolgecaj dhe deri në vitin 1941 qëndroi pranë familjes në fshat. Në vitin 1942, gjatë kohës që kryente shërbimin ushtarak, ra në kontakt me shokë të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe së bashku me një grup shokësh u arratis nga ushtria. Kur u kthye në shtëpi, u bashkua menjëherë me çetën territoriale të Lumit të Gashit. Armiku për aktivitetin e tij revolucionar u përpoq ta zhdukte dhe familjen t’ia persekutonte. Familjarët u detyruan të jetonin për një kohë në Brodoznicë. Mushaku mori pjesë në disa aksione: si në aksionin në rrugën Pejë-Gjakovë, në Krumë, ku u shkatërrua posta e xhandarmërisë, në Zherkë, ku luftoi trimërisht kundër forcave të shumta të Pashuk Bibës etj. Kudo ai luftoi me trimëri. Në korrik të vitit 1944 u pranua në radhët e PKS dhe me krijimin e BrXXVS u emërua komisar kompanie. Në këtë periudhë në zonat e Veriut reaksioni vendes grumbullonte forca dhe kërkonte t’i mbante këto nën ndikimin e vet.

Partizanët e BrXXVS zhvilluan luftime të shpeshta me forcat reaksionare të grumbulluara në Veri si në Theth, Nikaj e Mertur. Në këto përpjekje në rreshtat e para ishte dhe komisar i kompanisë Mushak Rustemaj. Në dhjetorin e vitit 1944 mori pjesë në luftimet e ashpra që zhvilloi brigada jashtë kufijve të Atdheut si në Ferizaj e Judovnik. Vdiq në spitalin partizan të Ivanës, në shkurt të vitit 1945. Është shpallur Dëshmor i Atdheut më vendim nr. 52, datë 04.11.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tropojë.

Mos më qani...vazhdoni luftën
Qazim Maliq Shehu lindi në Shtiqën të Kukësit më 1918, në një familje patriote. Kreu shkollën fillore dhe vështirësitë ekonomike të familjes e detyruan të marrë rrugën e kurbetit... e kaliti puna, vuajtjet dhe jeta prej punëtori në Kosovë e Maqedoni. Në dhjetor 1941 pranohet në Partinë Komuniste dhe nisi aktivitetin luftarak. Në Tetovë punonte dhe bëri jetën e një militant dhe pjesëtari të njësitit gueril. Ai ka marrë pjesë në aksionet e njësitit në marrjen e armëve, në likuidimin e spiunëve, në djegien e depove armike, në marrjen e dokumenteve të komandës gjermane etj. Në kushtet e luftës ilegale, kreu një aktivitet dhe si ndërlihdës i njësiteve partizane të krahinës së Lumës me Kosovën etj.

Në vitin 1943 Qazimi kalon në radhët e brigadave partizane në

Kosovë, ku zgjidhet zëvendëskomandant kompanie dhe pas komandant kompanie. Në vitin 1944 kryen detyrën e komandantit të batalionit duke shfaqur aftësi, trimëri, shkathtësi dhe mprehtësi në luftime. Në betejë e fundit mars 1945, duke sulmuar e treguar si gjithnjë shembull të lartë heroizmi e guximi prej militanti komunist, fjalët e fundit ishin “Mos më qani. Vazhdoni luftën!” Është shpallur Dëshmor i Atdheut më vendim nr. 104, datë 13.9.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Kukës.

MOS U SHQETËSONI, JAM PLAGOSUR LEHTË

Prek Mani lindi në fshatin Tetaj të Lekbibajt në vitin 1922. Familjen e tij shquhej për ndjenja patriotike, ndaj regjimi zogist e persekutoi, ndaj familja u detyruan të largoheshin nga fshati dhe nisi jetën e kaçakëve, maleve e shpellave të Tropojës e të Kosovës. Preka jetoj për disa vjet në Romoc të Gjakovës. Aty vazhdoi klasën e katërt të fillores, ku u dallua për zgjuarsin e urtësi. Por atë e përjashtuan nga shkolla, mbasi xhaxhai i tij ishte i arratisur. Vuajtjet e burrëruan para kohe, e bënë më të fortë. Më 1937 u kthye në vendlindje së bashku me të afërmit e tij. Në tetor 1944 u bashkua me forcat e BrXXVS. Ky ishte një gëzim për Prekën. Në luftimet në Qafë të Kolpit ashtu dhe në luftimet e tjera për çlirimin e asaj zone u tregua i zgjuar e trim. Në nëntor 1944, mbas çlirimit të Tropojës, BrXXVS, vazhdoi luftën përtej kufirit për çlirimin e popujve të Jugosllavisë. Në luftimet që zhvilluan forcat partizane kundër gjermanëve dhe çetnikëve në territorin e Jugosllavisë Preka u shqua për guxim. Vdiq në duart e shokëve partizanë, në spitalin e Ivanës, nga plagët e rënda që mori në luftimet e zhvilluara në malin Judovnik në janar 1945.

Është shpallur Dëshmor i Atdheut më vendim nr. 52, datë 04.11.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tropojë.

JAM MIRË, VAZHDONI RRUGËN...

Oso Cakraj ishte 17 vjeç, kur në mëngjesin e 28 gushtit 1943, shkante drejt Valbonës për të marrë pjesë në kuvendin historik të Malësisë. Ai ishte lindur në vitin 1926 në një familje të varfër, por Oso, por i kuptonte problemet e mëdha të popullit dhe kishte pjekurinë e një burri të rrahur në jetë. Mori pjesë në mbledhjet e formimit të batalionit territorial “Rinia” më 27 nëntor



1943, në fshatin Tplan. Ndërsa më 6 nëntor 1944, me krijimin e BrXXVS u radhit në batalionin e dytë të brigadës. Luftëtarët kishin parë tek Oso tipare të karakterit të tij, humor të këndshëm, besim në fitoren dhe të ardhme të lumtur.

Në dimrin e ashpër Oso me luftëtarë po i ngjiteshin malit të ashpër për të ndjekur nazismin dhe përtej kufijve të atdheut. Oso kishte zënë një pozicion luftimi, kur një predhë mortaje gjermane qëllloi pranë tij. Luftëtarin e ri e mbuloi dhe e bora.

Oso u ngrit dhe duke shkundur dheun e borën, pa shokë të shqetësuar që e shikonin dhe u tha “Nuk kam gjë, jam mirë”. Pastaj u përku, zuri vend në pozicion dhe filloi të shtjerë pa pushim mbi fashistët. Kështu, me vetëmohim luftoi Oso në të gjitha betejat ku mori pjesë. Por në rrugën dimërore plot ngrica e të ftohtë jashtë atdheut përveç gjermanëve e reaksionarëve vendas, u shfaq dhe një armik i ri, sëmundja e tifos.

Pikërisht në një “spital” me të sëmurë të tillë, u nda nga shokët dhe djaloshi 19-vjeçar nga fshati Lugaj, Oso Daut Cakraj, në fillimin e muajt prill 1945. Ai është shpallur Dëshmor i Atdheut më vendim nr. 52, datë 04.11.1969 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Tropojë.

(Marrë nga Gazeta Destinacioni, 14/04/2025)

IN MEMORIAM

Dhjetra personalitete akademike dhe të letrave në promovimin e librit "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave" të shkrimtarit dhe publicistit -Mjeshtër i Madh

HALIL RAMA

PROMOVON LIBRIN E 28 -të

**Nga Sakip Cami –
Shkrimtar & publicist**

Me 28 libra: monografi, profile, reportazhe, tregime e kritikë letrare dhe nëntë dokumentarë televiziv (si skenarist dhe regjisor), Halil Rama renditet padyshim ndër shkrimtarët dhe publicistët më produktivë e cilësorë.

Librat e tij janë vlerësuar nga personalitete të letrave shqipe, si Teodor Laço, Prof.Dr.Shaban Sinani, Prof. dr.Bujar Kapexhiu-Nderi i kombit", Prof.Dr. Fatmir Terziu, Prof. Eshref Ymeri, poeti, prozatori dhe politologu Preç Zogaj, Dr.Mujë Buçpapaj, Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj, Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi, Dr.Hajri Mandri, Dr.Fejzulla Gjabri, nga shkrimtarët Ahmet Prençi, Shefqet Meko, Andon Andoni, Namik Selmani, Sakip Cami, Selman Mëziu, etj.

Krijimtaria e tij me poezi dhe reportazhe ka filluar që në moshën 16 vjeçare në gazetën "Zëri i Rinisë dhe "Ush-tima e Maleve". Janë plot 5 dekada krijimtari në publicistikë dhe në gjinitë të tjera letrare.

Me recensat dhe analizat e veprave letrare të Teodor Laços, Zija Çelës, Bashkim Hoxhës, Shefki Karadaku, Preç Zogajt, Fatmir Terziut, Ahmet Prençit, Eshref Ymerit, Shefqet Mekos, Flamur Buçpapajt, Avni Ndreut, Barie Çupit, Demir Rusit, Mevlud Bucit, etj., Halil Rama është bërë tashmë i mirënjohur për lexuesin e publikun e gjerë...

Në librat e tij, Halil Rama prezantohet si mjeshtër i profilit, duke krijuar personazhe si shembëlltura që të mbeten në kujtesë. Tërë publicistika e tij është në një linjë vetëpërbushëse, ku autori me mjeshtëri di të përveçojë protagonistë të veshur me detaje që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshtërisht. Veçanërisht në monografitë e botuara dy vitet e fundit: "Muhurri, histori dhe personalitete", (me 712 faqe në 17 kapituj) dhe "Fluturon shqipja mbi Korab", si dhe në librat e shkruara dekadën e fundit nga ky autor, zbulohet thelbi i marrëdhënieve njerëzore. Jetët e personazheve realë, janë të mbushura me

pasione dhe emocione të pandalshme, drejt sfidës së jetës, drejt suksesit. Shkrimi i tij depërton thellë në shpirt dhe zbulon botën delikate të intelektualëve dibranë, kukësiyanë, durrsakë, shkodranë etj, në strukturën e tyre si njerëz të matur që veprojnë në kontekst duke marrë prej tij, maksimalisht suksesin. Ashtu siç është edhe vetë në jetë autori Halil Rama, personazhet realë që përshkruan në librat dhe esetë e tij janë karaktere që bartin dashuri dhe buonsens, veti të qenësishme inteligjence. Në fushën e të shkruarit dhe në disa institucione ku ka punuar evidentohet këmbëngulja dhe vullneti i tij për të studiuar, për të mbledhur burimet parësore, për të mësuar nga përvoja e tjerëve që është pjesë e stilit të punës kërkimore të Tij.

Ai i vendos intelektualët që nuk jetojnë dhe ata që jetojnë dhe kontribuojnë ende, secilin në vendin dhe piedestalin e merituar. Dashuria dhe ngrohtësia me të cilat i mbështjell ata, janë shprehje e humanizmit dhe shpirtit patriot, demokrat e liridashës të autorit. Lexuesi mund të shijojë drejtpërdrejtë nokturnet dhe romantikën që shpërfaqen në librat e H.Ramës (për gjeneral Rrahman Parllakun, Liri Belishovën, Muharrem Xhedikun, Skënder Çalën etj) shkruar me një stil të rrjedhshëm, që ngjajnë me një ese të gjatë liriko-epike, si një databazë e plotë e vlerave të tyre, duke plotësuar harmonishëm tablonë gjigande të njerëzve të ditur, të urtë e patriotë. Veçanërisht "Muhurri, histori dhe personalitete", "Fluturon shqipja mbi Korab", "Magjia e fjalës", AND-ja e pandryshuar e Shefki Karadaku" dhe "Ekzaminimi i diktaturës në vepra letrare", të botuara në harkun kohor të tre viteve të fundit (2019-2022) lexohen këndshëm nga përdorimi me mjeshtëri i mjeteve gjuhësore dhe stilistike, ngjyrimëve emocionale që

• Në librat e tij, Halil Rama prezantohet si mjeshtër i profilit, duke krijuar personazhe si shembëlltura që të mbeten në kujtesë. Tërë publicistika e tij është në një linjë vetëpërbushëse, ku autori me mjeshtëri di të përveçojë protagonistë të veshur me detaje që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshtërisht



fitojnë ngjarjet dhe personazhet, nën talentin dhe profesionalizmin e Halil Ramës.

Siç shprehet shkrimtari dhe publicisti i njohur Shefqet Meko: "Halil Rama shkruan thjesht, pa bujë dhe bërtitje, me gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme qartë dhe rrjedhshëm. Ai e përdor fuqinë shprehëse të shqipes si "antikorp" gjuhësor ndaj çdo huazimi të huaj, që ka çibanuizuar lemeritshëm shtypin, rrjetet sociale, median dhe ekranet shqitare.

QËMTUES I HOLLË I NGJARJEVE E FENOMENEVE SHOQRORE DHE POLITIKE

Në 28 librat e tij ai sjell artistikisht ngjarje e personazhe që të lënë mbresa, por dhe jehonën e vendlindjes së tij të bukur dhe të dashur, si shembëlltura e jehonës që vjen nga e shkuara tek e sotmja dhe na zgjon të gjithëve e na thërret, për me shumë humanizëm, dashuri e dinjitet.

Halil Rama si gazetar profesionist në shumë gazeta ditore e periodike ka shkruar për të gjithë Shqipërinë, bile edhe për Kosovën e mbarë shqiptarinë, por në librin e tij të 28-të ai përzgjedh ngjarje e personazhe të Dibrës, vendlindjes së tij.

Mjeshtri i Madh Halil Rama është qëmtues i hollë i ngjarjeve e fenomeneve shoqërore dhe politike, personazhet e këtij autori, asnjëherë nuk kanë qenë rastësor dhe të çfarëdoshëm, por janë të përzgjedhur dhe me vlera e kontribute në fushat e tyre.

Nga viti 2010, boton në vijimësi

opinione, dossier dhe reportazhe në të përjavshmen letrare&kulturore "NACIONAL", në të përditshmet "Panorama", "Gazeta Shqiptare", "Koha Jonë", "Telegraf", "Standard" dhe "Dita", sidhe në portalet vision.com; fjala e lirë: alb-spirit, etj Halil Rama deri më tani, ka shkruar e botuar 28 libra: monografi, reportazhe, tregime, poezi e kritikë letrare; që të gjitha të mirërealizuara dhe me vlera ideo-artistike, të cilat kanë përcjellë te lexuesi i shumë vlera të padiskutueshme letrare, historike e shoqërore dhe ka në provës vëllimin e dytë, po për vlerat dibrane, të cilat nuk mund të ezauroheshin në një libër të vetëm.

PROMOVIMI

Të shtunën e datës 12 prill 2028 në sallën e kinemasë "Maks Velo" u bë promovimi i librit të tij të fundit, të 28-të, me praninë e qindra përfaqësuesve të komunitetit dibran dhe jo dibran, ku mes tyre ishin dhjetra akademikë e shkrimtarë, si: Prof.dr. Ylber Bezo – rektor i KUB, Akademik Adem Bunguri, Prof. Dr. Gafur Muka, gjeneral-major Manushaqe Shehu –doktore e shkencave, kryetarja e OBVL Tatjana Parllaku-Çarkaxhiu, Prof. Dr. Nazmi Koçi, prof. Dr. Islam Dauti, Presidenti i Unionit të të Përndjekurve Politikë Besim Ndrejoni, shkrimtarët e poetët Emy Krosi, Dr.Fejzulla Gjabri, Barie Çupi, Xhelal Marku, Xhelal Murati, Arben Alliu, Shaqir Çerpja, Shaqir Skarra etj.

Kjo veprimtari u moderua nga reg-

Vijon në faqen 9



FJALA

Halil Rama, mjeshtër i gdhëndjes së portreteve të figurave të shquara të kombit tonë

Nga Tatjana Parllaku-Çarkaxhiu

**Të nderuar pjesëmarrës,
Të dashur miq!**

Është kënaqësi e veçantë për mua, që në emër të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacional Çlirimtare të përshëndes këtë veprimtari mbi promovimin e librit të 28-të të shkrimtarit, publicistit, historianit dhe skenaristit të njohur Zotit Halil Rama.

Ai ka qenë pjesëmarrës i grupit nismëtar të themelimit në organizatës sonë krahas personaliteteve të shquara të vendit tonë si Imer Dishnica, Rrahman Parllaku, Edip Ohri, Liri Belishova, Skënder Malindi, Myfit Guxholli, Sotir Budina etj.

Halili, ndonëse më i riu në moshë dha një kontribut të jashtëzakonshëm në krijimin, ngritjen dhe konsolidimin e kësaj Organizate që sot përfaqësohet nga ne pasardhësit e tyre që krenohen me gjakun dhe jetën e atyre bijve dhe bijave të Shqipërisë, që luftuan me heroizëm për fitoren e lirisë.

Këtë e tregon më së miri libri i Halil Ramës "30 vjet OBVL, histori sukse-si dhe fitoresh". Ai është mjeshtër i gdhëndjes së portreteve të figurave të shquara të kombit tonë.

Si regjizor dhe skenarist, ai ka kontribut të veçantë në dokumentarët dhe filmat e realizuar me mjeshtëri, duke pasqyruar heroizmin e popullit shqiptar në shekuj duke filluar nga rilindja kombëtare e deri në diët e sotme. Ai ka përditësuar me mjeshtëri të gjitha ngjarjet e luftës çlirimtare të U.Ç.K-së dhe sot përditëson me përkushtim në shtypin e përditshëm të gjitha aktivi-



tetet me rëndësi kombëtare, rajonale dhe botërore. Veçanërisht vlerësoj dok- kumentarin e plotë kushtuar jetës dhe veprës së Fadil Hoxhës. Është meritë

e paçmuar e Halilit që sot organizata jonë është simotër e Organizatës së Veteranëve të Kosovës, dhe pjesë e Organizatës Botërore të Veteranëve të Luftës së II-të Botërore.

Ai ka dhënë kontribut të madh në promovimin e vlerave historike të lirisë, të dashurisë për Atdheun, për drejtësinë në mënyrë që ne pasardhësit e veteranëve t'ja u lëmë trashëgim brezave të rinj.

Halili është jo vetëm një bashkëshort shembullor, një baba i kujdesshëm dhe një gjysh i dashur, por Halili është i kujdesshëm për të ndihmuar sadopak veteranët e moshuar që janë ende gjallë dhe për t'ju gjendur atyre pranë në çdo kohë. Kjo e bën Halilin të dashur jo vetëm për ju Dibranët, por edhe për të gjithë shqiptarët, kudo që ndodhen. Unë personalisht e vlerësoj Halilin jo vetëm për 5 librat kushtuar jetës dhe veprës së Babait tonë, një në bashkëpunim edhe me historianin Sakip Cami, por edhe për praninë praninë e tij të çmuar në jetën e babait tonë duke qenë si djali i familjes dhe sot si një vëlla për ne.

Së fundmi, dua të falenderoj Halilin për kontributin e tij në Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës. Në shtypjen e Gazetës "Veterani", ku shpalosen vlerat kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të veteranëve dhe pasardhësve të tyre.

Ti uroj shëndet, jetë të gjatë dhe suksese të mëtejshme në krijimtarinë e tij të çmuar!

• **Fjala në promovimin e librit të Halil Ramës "Diba dhe dibranët në paneonin e vlerave"**

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu:

Një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor

Vijon nga faqja 8

jizori i mirënjohur Llesh Nikolla.

Në dokumentarin: "Rrugëtim në krijimtarinë letrare e publicistike të



shkrimtarit Halil Rama" ndër vite, me skenar të Mimoza Kurtit dhe realizimin e Dëfrim Methasanit të pranishmit u njohën në mënyrë të përmbledhur me botimet dhe nderimet e autorit.

Prof. asoc. Dr. Bernard Zotaj, recensent i librit dhe autor i parathënies në fjalën e tij ne vuri theksin te patriotizmi vlerë e përherëshme e dibranit.

Në emër të LID, përshëndeti Prof. asoc. Dr. Shpëtim Cami, kryetar i Lidhjes së Intelektualëve dibranë, i cili vuri në dukje se Halil Rama ka dhënë një kontribut të madh për Dibrën dhe Shqipërinë, por edhe Dibra, konkretisht Bashkia e Bulqizës e ka shpallur Qytetar Nderi dhe Presidenti i Republikës i ka vlerësuar me dekoratën e "Mjeshtër të Madh".

**GJENERALMAJOR
MANUSHAQE SHEHU:
NJË LIBËR RACIONAL,
EMOCIONAL, DOKUMENTAR,
ARKIVOR**

Në këtë event mbresëlënëse përshëndeti gjithashtu Gjeneralmajor



Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare me këtë gradë madhore, që nderon jo vetëm Dibrën, por shqiptarët kudo në botë.

Në fjalën e saj ajo theksoi se autori nëpërmjet 70 personazheve të këtij libri, na njeh jo vetëm me jetët e tyre të letrarizuara aq bukur, por edhe me fakte dhe ngjarje historike të panjohura, të trevave që ato u përka-sin, që nga Kalaja e Dodës, Lura, Zall

Dardha, Muhurri, Katër Grykët, Sohodolli, Golloborda, Okshtuni e Bulqiza. Dua ta falenderoj për zemërisht autorin, që në këtë panteon vlerash dibrane më ka renditur edhe mua, ashtu si dhe gjeneralin e famshëm Dali Ndreu komandantin e mirënjohur Ismail Shulku e deri te gjenerali më i ri dibran Hamdi Doda.

Vijon në faqen 15

IN MEMORIAM

Vrasja më e madhe e shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë, ndërsa kriminelët s'u dënuan kurrë

NË MASAKRËN E MEJËS U VRANË 376 SHQIPTARË

Nga Bashkim Hisari

Gjatë festave të fundit, në Frankfurt të Gjermanisë, takova mikun tim Noah. Me mburrje foli për ditët që kishte kaluar në Kosovë ku pas çlirimit shërbeu si ushtar në misionin e KFOR-it. Kryfjalë në bisedën tonë ishin ngjarjet në Kosovë. Më pyeti pse Kosova ende nuk ka marrë veprime të plota ligjore për të paditur Serbinë për akte të gjenocidit serb, veçmas duke përmendur masakrën në Meje dhe, pse Kuvendi i Kosovës po dështon për të siguruar 61 vota për të zgjedhur kryetarin? Nuk arrita dot t'i përgjigjem plotësisht.

Por, çfarë ndodhi në Meje në mujin prill të vitit 1999?

Para 26 viteve, NATO nisi fushatën ajrore për të ndaluar krizën e krijuar humanitare, spastrimet etnike, dhunën, vrasjet masive dhe krimet tjera ndaj civilëve shqiptarë që i kryenin forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe dhe jugosllave. Banorët e disa fshatrave në Luginën e Rekës së Keqe të komunës së Gjakovës përjetuan dhunën më të egër. Refugjatët nga gjithë Kosova që kishin gjetur strehim në këtë zonë në fshatrat Meje, Korenicë, Ramoc, Dobrosh, Mulliq, Brovinë, Guskë, Orizë, Nivokoz dhe fshatra tjera, duhej të largoheshin me dhunë në Shqipëri ose do të ekzekutoheshin.

Më 27 dhe 28 prill 1999, gjatë një ofensive të gjerë të forcave serbe, në Meje ndodhi vrasja më e madhe e shqiptarëve gjatë luftës në Kosovë. U egzekutuan në mënyrë sistematike 376 burra dhe djemë të moshës 14 deri 87 vjeç të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në radhët e luftëtarëve të UÇK-s dhe në luftime. Trupat e 309 të vrarëve janë gjetur në vitin 2001 në varreza të fshehta masive në Qendrën e Trajnimit Policor në Batajnicë, në periferi të Beogradit.

Sipas dëshmitarëve, masakra në Meje ishte kryer si një hakmarrje ndaj vrasjes të pesë policëve serbë nga UÇK. Këto akte të gjenocidit, forcat serbe i kishin përgatitur në detaje. Në operacionin e zhvilluar me emrin "Operacioni Reka", kishin marrë pjesë 500 ushtarë të Ushtrisë Jugosllave, 400 të Punëve të brendshme dhe vullnetarë të ardhur nga Serbia, Bosnja dhe Mali i Zi. Pjesëmarrës kanë qenë edhe të ashtuquajturit "Tigrat e Arkanit". Operacionin e kishin mbështetur Brigada 549-të e Motorizuar e Ushtrisë Jugosllave nën komandën e gjeneralit serb me prejardhje nga Gjakova, Bazhidar Deliq. Ai në vitin 1999 mbante një nga postet më të rëndësishme në luftën e Kosovës. Një dëshmitar i mbrojtur me kodin K41, që ishte pjesë e kësaj Brigade, gjatë gjykimit të S. Millosheviqit në Hagë, tha: "Ne morëm urdhër (prej Deliqit) për të qëlluar ndaj çdokujt që



Zef Hasanaj-dëshmitari i masakrës në Meje

lëvizte" Pas luftës në Kosovë, Deliq, u bë zyrtar i lartë i Partisë Radikale Serbe të kriminelit Vojislav Sheshel, qe deputet dhe nënkryetar në Kuvendin e Serbisë. Ai nuk mohoi që ishte komandant i Brigadës 549, por mohoi të ketë kryer krime luftime. "Unë e dija se çfarë po ndodhte në zonën nën përgjegjësinë time. Isha gjithmonë në vijën e parë të sulmit", deklaroi Deliq në Hagë, por ai nuk u dënuar!

Para se të niste operacioni në Meje, forcat serbe kishin bllokuar të gjitha rrugët që mundësonin dalje. Pastaj, ata kanë hyrë në fshatrat e banuara me shqiptarë dhe u kanë urdhëruar banorëve të shkojnë për në Shqipëri. Gjatë dëbimit kanë vrarë me dhjetëra civilë. Në fshatin Meje, kolonat me mijra refugjatë kanë kaluar nëpër dy postbllloqe, të cilat i kishin formuar policët e Sekretariatit të Punëve të Brendshme të Gjakovës. Në këto postbllloqe, policët serbë i ndanin meshkujt, kurse grave, fëmijëve dhe pleqëve u urdhëronin të vazhdonin rrugën për në Shqipëri. Në postbllloqe janë ndaluar 274 meshkuj, në mesin e të cilëve kanë qenë 36 të moshës jomadhore. Të gjithë janë vrarë në lokacione të ndryshme afër postbllloqeve.

Se forcat serbe kishin bërë krime më barbare duke demonstruar forcën dhe zbatuar akte gjenocidi, tregoi inxhinieri i diplomuar i bujqësisë nga fshati Meje, Zef Hasanaj që kishte përjetuar këto ngjarje të dhimbshme. Policia speciale serbe dhe njësitë paraushtarake kishin vrarë shumë bashkëvendas të tij. Nga bombardimet ishin vrarë vëllezërit Leka 32 vjeçar dhe Martini 29 vjeçar dhe e kishin plagosur rëndë atë bashkë me babain Sadriun dhe nënën Nushe. Zefi tha se vrasjet masive në Meje kanë filluar më 14 prill 1999 dhe kishin vazhduar sidomos më 27 dhe 28 prill, kur lufta në Kosovë ishte në kulmin e saj dhe NATO-ja ishte në intenzitetin më të madh të bombardimeve kundër caqeve policore-ushtarake serbe.

"Derisa dëgjoja lajmet në radio, nga dritarja e shtëpisë e pash kolonën

gjithëve", përshkruajti Zefi atë që kishte pa dhe përjetuar. Në ato momente ai kishte parë një avion që fluturonte shumë lartë që lëshonte tymë dhe pas pak kishte filluar të bombardon. "... pas bombardimit, me gjysmën e trupit përfundova nën "ploçën" e shtëpisë që u rrënuar. Pjesët e predhave më kishin goditur. Pothuaj tërë trupin e kisha të djegur. Isha pa vetëdije. Në atë moment nuk më treguan se dy vëllezërit e mi ishin vrarë". Pastaj për shkak të plagëve që kishte, Zefi është keqëtrajtuar, kahdo që kishte kaluar nëpër vështërsi ekstreme dhe kishte përjetuar të zit e ullirit të shkaktuara gjatë shërimit të plagëve. Trajtim mjekësor ka marrë në spitalin e Gjakovës, në spitalin italianë në Kukës, në atë Austri në Shkodër dhe në tri spitale në Cirihi-Zvicër.

Fatmir Berisha kishte ardhur nga Gjermania dhe ishte rreshtuar në radhët e UÇK-së. Menjëherë pas lufte, ai, bashkë me vëllanë e tij, Ferdinandin, kishin shkuar në fshat për të gjetur familjarët. Në shtëpinë e tyre, plotësisht të djegur deri në themel, nuk kishin gjetur asgjë. E gjitha që kishte shpëtuar ishte një foto familjare, kurse në një murë me tulla ngjyrë të kuqe, kishte parë mbishkrimin me germa të zeza "Arkan". Bashkëfshatarët kishin treguar se aty ua kishin vrarë babën, nënën dhe vajzën, por trupat e tyre nuk i kishin gjetur. Pranë një kanali jo larg postbllokut në Meje, ai, bashkë me banorët e fshatit, kishin gjetur mbi 100 kufoma.

Masakra e Mejës ishte dëshmi e qartë e akteve gjenocide dhe krimeve kundër njerëzimit që kryen forcat serbe. Këto krime janë dokumentuar nga organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe përfshihen në aktakuzat kundër liderëve serbë në Gjykatën Ndërkombëtare për Krime Luftime për ish-Jugosllavinë.

Për vrasjen e 376 shqiptarëve të pafajshëm në Meje nuk u dënuan të gjithë kriminelët serbë. Kriminelët nuk u dënuan as edhe për masakrat tjera të kryera dhe të dëshmuara me faktografi. Ndaj, organe e Kosovës, sa më pare dhe me ngulm, duhet të kërkojnë që fajtorët, për krimet e bëra të ndiqen dhe ndëshkohen.



Varret e viktimave të masakrës në Meje

SKICË

Haki Uka në një portretizim të veçantë

Nga Agim Golemi

Mëngjesi i largët i 23 nëntorit 1972, gdhiu i ftohtë si lajmetar se dimri vetëm zyrtarisht nuk kishte hyrë. Qielli dukej i zymtë, në ngjyrë gri të errët. Retë vërtiteshin të harbuara si të ziheshin përlesh të kokës me njëra tjetrën, kush e kush të shfrynte stuhinë. Era të priste brisk. Me pushimin e saj pritej dhe shiu.

Sikundër koha, nxanim dhe ne oficerët e rinj që në një ditë të tillë do të zhvillonim alpinizëm. Ishim titulluar oficerë, por stërvitësim për gjashtë muaj në rol të ushtarit në Detashmentin e zbulimit Zall-Herr. Alpinizmi ishte nga disiplinat më të vështira. Nuk e kishim të mësuar në shkollë, por nuk kishim as aftësitë fizike për të përballuar vështirësi si zbritje-ngjitje me litar në lartësi, ngjitje në shkëmbinj pa u lidhur, vetëm me ndihmën e gozhdëve dhe çekiçit, kalim pengesash ujore, hedhje nga kulla e parachutizmit etj. Këtë lëndë na i jepte instruktori Azem. H., alpinist i kategorisë së parë, tepër i edukuar, profesionalisht i pa arritshëm, i respektueshëm nga të gjithë ne. Ashtu kokëulur, pa fjalë, të fshehur brënda pelerinave nga të ftohtët, të kërrusur prej lodhjes së rrugës, nën peshen e merzities por edhe të armatimit dhe paisjeve alpinistike, mbritëm më në fund te vendi i stërvitjes, aty ku ngrihej diga e ujës-jellës të Bovillës, në atë kohë e pa përfunduar tërësisht dhe ujrë që rridhnin nga mali i Murrizit, (atë mëngjes kishte vënë festën e bardhë), shkarkoheshin në pjerrësi dhe me shpejtësi si të dilnin prej turbinave.

Instruktori Azem pas formaliteteve të para të apelit, komunikoi temën: - Kalimi i pengesave nëpërmjet teleferikut. Mbas dha udhëzimet përkatëse për lidhjet personale, tetëshe, gogël, shaluar, vendosjen e ganxhave etj, mori litarin kolektiv dhe atë ndihmës kolektiv, lidhi njërin krah të litarit në të majtë të digës, te shkëmbinjt ku sot



të apasionuarit mbas natyrës shijojnë bukuritë e liqenit, ndërsa për te lidhur krahun tjetër kapërceu lumin nga shkëmbi në shkëmb me një shkëputje sportive nga vëndi, ku iu ngjit pjerrësisë me maja shkrepë në krahun e djathtë të digës. Lëshimi që na bëri atë ditë ishte se na la mundësinë të zgjidhnim; ose të ngjiteshim me forcën e krahëve nga poshtë - lart, ose të kalonim lumin dhe të realizonim zbritjen nga lartë - poshtë. Që të dy variantet ishin të vështira. Ngjitja me forcën e krahëve në një pjerrësi 45 gradë dhe në gjatësi 50 m, aq sa ishte gjatësia e litarit kolektiv, ishte e pamundur. Mund të ngjiteshim me sforco deri në mes të litarit, por do të ngeleshim aty si mish i varur në çengel. Varianti tjetër, zbritja nga lart-poshtë ishte e lehtë, rrëshqisje vet, por vështirësia ishte te kalimi i lumit (lumi i Tërkuzës). Pjesa më e ngushtë e kanionit që mund të kalohej ishte midis dy shkëmbinjve të mëdhenj, të lëmuar prej erozionit. Distanca ishte 3.5 deri 4 metra. Lehtësisht të gjithë mund ta kalonim këtë distancë sikur mos të ishte frika e prurjes së

madhe të lumit dhe lartësia më shumë se pesë metra.

U vumë në mendim. Trupi na dridhej prej të ftohtët por edhe prej frikës. Gjithsecili në mënyrë të heshtur zgjodhi variantin që i dukej pak më i mirë. Shumica zgjodhi ngjitjen me forcën e krahëve nga poshtë - lart. E "dorëzuam" jetën në dorë të instruktor Azemit. Nuk do na linte varur. Do jepte, do jepte dhe do na tërhiqte si rimorkio, me litarin kolektiv ndihmës. Vetëm njëri prej nesh nuk e kishte ndarë mendjen akoma. Ai ishte shoku jonë Haki U.

Meqënëse Hakiu është admini i kësaj skice, po i bëj një portretizim të veçantë. Ishim (dhe jemi) shok që prej shkollës së mesme ushtarake; Hakiu, shok i urtë, tip studiues, me njohuri të mira të gjuhës angleze, me trup të gjatë, të hollë si filispanjë, të drejtë si valltarët dibranë prej dhe nga vinte, por me një muskulaturë të dobët siç ishte pjesa më e madhe e jona. Si djali i ri në vakt e mbante veten sqime. Kishte krijuar një raport specifik me flokët e tij dhe një varësi absolute. Kjo varësi u rrit më shumë sidomos në shkollën e oficerëve ku na lejonin të mbanim flokë, pavarësisht qethjes balaboks që na bënë dhe që ne e urrenim aq shumë, (ndërsa sot kjo qethje është në modë). Flokët i kishte disi të rrallë, të krehura në ç'do moment anash, në ngjyrë gështenj dhe që të linin përshtypjen se me kalimin e viteve do t'i binin para kohe. I ishte bërë refleks që t'i krehte orë e çast, kudo që të ndodhej, në mësim, stërvitje, pushim. Edhe kur shpjegonte pedagogu, nxirrte pasqyrën, krehërin, ulte kokën nën tavolinë dhe rregullonte flokët. Do ta gjente që do ta gjente kohën e duhur. Tani që kishte dalë dhe oficer e kishte kohën pa limit.

Siç shpreha më lartë, Hakiu nuk e kishte ndarë mendjen por, po bënte prova për të kaluar lumin. Asnjëri prej nesh nuk i kushtoi vëmendje. Asnjëri prej nesh nuk i shkoi ndërmend se do ta kryente këtë veprim. Në një çast që Ai mendoi se mund ta kalonte, mori fuqi, trokiti si në pedanë në pllaken e lëmuar të shkëmbit, u shkëput

për të mbritur te pllaka tjetër por... nuk arriti të shkelte në shkëmbin matanë duke u lëshuar pingul si hedhje prej trampolinës në rrjedhën e zhurmëshme si gjësim deti të lumit. Nuk arriti për faktin se rrëshqiti nga lagështia prej ciklave të ujit që binin mbi pllakat e gurta. U ngritëm të gjithë për ta shpëtuar duke ndërprerë ç'do veprim tjetër, por nuk e pamë më për asnjë moment. Shkëmbinjt në pjesën fundore të tyre formonin zgavra të thella ku ujët rrotullohej rrathë - rrathë si valë elektromagnetike. Në këto zgavra të ujit luftonte Hakiu me vdekjen, pa u parë nga ne. Nuk po jepte asnjë shënjë që të dilte sadopak mbi ujë. Po ta shikonim do të kapeshim dorëpërdorë siç na kishin mësuar për kalimin e lumenjve dhe do të hidheshim për ta ndihmuar. Veçanërisht instruktori Azem që kishte përgatitjen e duhur për këto veprime, por që kishte dhe përgjegjësinë e madhe ligjore, do bënte gjithçka dhe me mjetet e alpinizmit që ta shpëtonte.

Por jetëgjati nuk bëhet jetëshkurtër. Në distancë, më shumë se 100 m. nga ku ishim ne, aty ku rrjedha e lumit normalizohej, ku binte disi në qetësi dhe krijonte një farë vahu, u çfaq në mes të lumit si feniksi nga hiri, shoku jonë Hakiu. Kishte shpëtuar me thonj. (Në vëndet ku uji rrotullohej, si duket i krijonte mundësi që të nxirrte kokën dhe të merrte pak ajër). U çua në këmbë. Ujtë i arrinte deri në mes të trupit. Hapi krahët anash për të lëshuar ujin nga rrobat që i peshonin sa gjithë shkëmbinjt përballë, hodhi sytë nga shokët, ngriti dorën lart sikundër bëjnë notarët kur mbarojnë garën dhe na përcolli një buzëqeshje të paqtë. E ndërsa ne, kush e kush të fliste më shumë që Ai të nxitonte të dilte në anë se nuk i dihej prurjes befasuese të lumit, ndërsa instruktori Azem lidhi litarët për t'ia hedhur që ta nxirrte, Hakiu e "kishte punën me nge, priste koha për të dalë". Nxorri nga xhepi i pantallonave krehërin, pasqyrën dhe filloi të krihte flokët. "S'kishte si të ndodhte ndryshe. Duhej ta sfidonte vdekjen dhe me bukuri".



SUPLEMENTI LETRAT

HOXHË BRUNGA I LURËS, EMBLEMË SHQIPTARIE

MEVLUD BUCI

Hoxhë Brunga ishte i thjeshtë si e vërteta. Kurdoherë me praninë e tij në popull, ai e shfaqte madhësinë e thjeshtësisë së tij me virtyte të rralla, si njeri i mirëpritur. Për Hoxhë Brungën, birin e Gur-Lurës, kanë shkruar e kënduar: Nikolin Guri-autor teksti virtuoz, Gëzim Ahmetaj -po kështu këngëtar, si dhe Alfred Qemalja-orkestrant virtuoz.

Figura e tij si legjendë dhe embleme shqiptarie nderohet nga vendlindja-Dibra dhe më gjerë.

Një këngë për të këndohet me vargjet: "Burra në za ka rrit vatani/ Hoxhë Brunga -ky imami/ për Hoxhë Brungën sa t'jetë jeta/ kënga do këndohet nëpër breza".

Nikolin Guri është autor i tekstit dhe kënga këndohet nga Gëzim Ahmetaj.

Po kush është Hoxhë Brunga?

Ai u shkollua në Stamboll u kthye në vendlindje dhe shërbeu me devotshmëri. "Njeri me dije e culture/ Caktohet imam në Lurë./ Atje në Dibër në Gur Lurë/ Na ka rrit shtat ky burrë..."

Këtu në Lurë Hoxhë Bruka dha prova të shërbimit ndaj vëllazërisë dhe të unitetit duke kultivuar te njerëzit besim, paqe e urtësi.

Kënga na pasqyron besimin dhe urtësinë, dhe vazhdon me vargjet: "Krenari të ka Gur Lura/ Hoxha jonë Sulejman Brunga"

Hoxha ishte jo vetëm fetar, por edhe doktor, edhe projektues, dhe mbi të gjitha atdhetar i flaktë, ndaj kënga e ngre atë në lartësinë e nderimit të njeriut të punës.

Hoxha nuk u përkul nga komunizmi edhe pse në rrethana të vështira ai diti ta përballojë çdo kufizim pa harruar shërbesat e tij fetare, as mësimet e tij morale të urtësisë që kishin lidhje me mësimet e fesë..Ai

diti të bëjë mirë edhe të ruajë vlerat e tij dhe të mesazheve të fjalëve të tij të urta.

Hoxhë Brunga jo vetëm ishte fetar, por ai diti edhe në ditë të vështira të ruajë fenë, të ruajë urtësinë dhe shpresën, si dhe besimin e palëkundur në Zot.

Ndaj vendlindja e tij krenohet me të, si njeri zemër madh, doktor e inxhinier, projektues i Sharrave me ujë. Ai punoi në Sharra të Dibrës, Pukës, Burrelit e në Kukës. Ai është fetari që u vinte në ndihmë njerëzve jo vetëm për shërbesat shpirtërore, por edhe për dobite praktike. Hoxhë Sulejman Bruka është veteran i qëndresës morale- njeriu i mirësisë dhe i dashurisë për atdheun, për njerëzit, njeriu i sakrificave të mëdha në dobi të komunitetit, prandaj kënga për të gjëmon e ndihet nëpër breza me vargjet: "Për Hoxhë Brungën sa të jetë jeta/ Kënga këndohet nëpër breza..."

Këto janë gjurmët që le në jetë një



njeri i përkushtuar ndaj atdheut të tij, që meriton vlerësimin jo vetëm të bashkëkohësve, por edhe të brezave më pas.

Homazh për Fatbardh Musabelliun

Zef Rozhani

Për miqtë tanë na merr shpesh malli për tu takuar. Kur kalojnë disa ditë mendojmë për to bile dhe të shqetësuar. Vendosa të kaloja njëherë nga puna e djemve të tij, atje ku shpesh e gjeja. Sapo këmba më shkeli në pragun e dyqanit vura re dy djemtë dhe një grua veshur në zi.

I përshëndeta me dorën në zemër, sepse Covid-19 sëmundja e mallkuar nuk na lejonte të takoheshim si dikur. I pyeta për mikun tim të shtrenjtë, Fatbardhin, sepse kisha kohë pa e parë. Djemve Tanit dhe Sajmirit, me ato fytyra burrërore, shkëlqen si kristal loti i pathyeshëm dhe iu bashkëngjit fraza: Babai na la! Nuk u besoja dot veshëve dhe doja t'i ngushëlloja siç i ka hije shqiptarit, por flama kishte ligjet e saj, distancimin social. U ula në karrige për të marrë vehten, por edhe për të mësuar më shumë. Ndërkohë djemtë dhe bashkëshortja Drita më tregonin unë kujtoja si e njoha këtë burrë fisnik, malësor jugu. Ne gazetarët, jemi kronikanët e pasazheve jetësore, kemi fatin të bëhemi pjesë e jetës e shoqërisë sonë.

Fatbardh Musabelliun e kam njohur në një tavolinë të ëmbël mes miqsh. Tek ai dallohej pamja e njeriut me prezencë mbresëlënëse, ku sytë e çiltër, vetulla fisnike, mustaqet e trashëguara nga i ati Vesel bej Ujaniku nga Skrapari, i kollarisur aq sa edhe pikturë të ishte, nuk do të kishte kombinim më perfekt.



Fatbardh Vesel Ujaniku lindi më 10 prill të vitit 1950 të shekullit të kaluar, fëmija i nëntë nga dhjetë fëmijët e Vesel Ujanikut. Ishte 12 vjeç kur u shpërngul nga ai fshat i bekuar për t'u vendosur në fshatin pashalli të Beratit. I mbetun jetim nga nëna, vendosi t'i bëhej krah babait të tij të mrekullueshëm. U vendos aty në ndërmarrjen e bonifikimit me punë të ndryshme. Ishte i dashuruar pas asaj pune mekanike ku eskavatorët e buldozerët ato mjete të fuqishme, hapnin kanale, thanin kënetat dhe pas gjithë asaj pune lulzon jeta, ku parcelat e pafundme gjelbëronin.

Nga dashuria për punën dhe profesionin që në moshë të re u bë

ndihmës e skavatorist. Duke parë aftësitë e tij profesionale atij djali tashmë gjigand iu besua drejtimi i një eskavatori. Tashmë ajo makineri me bigën e sajë drejt qiellit gërmonte dheun e baltosur për të çelur kanale kulluese dhe vaditëse. Dhe emri i tij, puna e palodhur bënë që ai të dallohej mes të tjerëve. 17 vjet fotografia e tij qëndroi në tabelën e njerëzve pararojë të punës mes qytetit të Beratit. Ai ishte i të gjithëve ishte vetë mirësia, ishte vetë shembulli.

Fatbardh Musabelliun ishte kryetar i Bashkimeve profesionale, organizatë që me zërin e tij ishte pranë halleve dhe problemeve të ndryshme të punonjësve.

E për këto ai ishte zgjedhur në presidiumin e këtij forumi në rrethin e Beratit. Zëri i tij tingëllonte fuqishëm kurdo e kudo për nevojat e punonjësve. Gjurmët e tij në punë dhe në jetë ishin kudo.

Eskavatoristi i talentuar ku nuk ka punuar në Rehovë Belesovë, Buz të Tepelenës në Pash Aliman të Vlorës e gjetkë.

Kudo që punoi shkëlqeu si mjeshtër i punës, vetëm një fakt të bind. Në bilancin e punës së këtij del që në vitin 1985 të shekullit të kaluar, ai kishte realizuar projektet e vitit 2000.

E kjo nuk do asnjë koment. Fatbardhin përveç punëtor i parajsës, e gjejmë edhe si politikbërës. Ai ishte një ndër delegatët dhe folësit në podiumin e Kongresit të 10-të të Partisë të asaj kohe. Ish delegatët e të tjerë e kujtojnë atë fjalim të tij plot

kritika dhe sugjerime që për kohën ishin të vështira. I thjeshtë si Ai dhe kurajoz vetëm të vërtetën. Edhe me ndërrimin e sistemeve ai nuk u nda nga njerëzit. Atij kurdo dhe nga të gjithë i dëgjohet fjala, sepse ai ishte i thjeshtë si e vërteta.

I devotshëm dhe trim ai nuk nguroi të mbronte votën në vitin e mbrapshtë 1997 si pjesë e komisionit të zgjedhjeve në Uznovë të Beratit.

Ai nuk dinte të bënte dallim në asnjë krah politik. Në tryezat e Partisë Socialiste të Beratit ai ngrinte zërin fuqishëm për drejtësi, pa dallime. E koha e solli që në vitin 2000 të vendosej në Tiranë.

Por ai nuk ndenji duar kryq, por ju përvesh punës e ku nuk e gjeje atë si drejtues ndërtimesh nga Jugu në Veri e në Mal të Zi e Maqedoni, së fundi në Klos të Matit, kudo e kurdo ai la gjurmë jete plot mirësi. Përveç punës ai pëlqente këngën. I pari në punë, i pari në këngë. Po bëhen dy vjet që djalin e Sajmirit e kanë pagëzuar me emrin e gjyshit të tij.

Mes nipërve e mbesave të dy djemve e vajzës së Fatbardhit do të jetë edhe Fatbardhi i vogël i cili plot ëmbëlsi përpara fotografisë së gjyshit shqipton o gjysi.

E ai burrë plot dinjitet prehet i qetë dhe jeton në kujtimet e të vetëve të Dritës asaj bashkëshorteje të mrekullueshme. Ai që nuk harrohet nuk vdes kurrë.

Më 5 janar 2021 pushoi ajo zemër e atij njeriu të mrekullueshëm.

SUPLEMENTI LETRAT



Shpendi Topollaj, Tribuna letrare për Durrësin


Nga Nuri BUFI

Shkrimtari i suksesshëm e pasionant Shpendi Topollaj, njihet për botimet e shumta në fushën e letërsisë, të sjella nëpërmjet disa gjinive letrare, si të romanit, novelave, kritikave letrare si dhe me lëvrimin e prozës e të poezisë.

Ai rrjedh nga një familje intelektuale. Formimi i tij nis me mbarimin e shkollës së mesme ushtarake "Skënderbej" dhe më tej me kryerjen e arsimin të lartë pranë Shkollës së Bashkuar të oficerëve në Tiranë. Në vitin 1966 titullohet oficer këmbësorie. Emërohet në repartet e Durrësit, ku kryen detyra të ndryshme, si instruktor i stërvitjes me universitarët, shef i stërvitjes së Brigadës së Katërt të Mbrojtjes Bregdetare deri Komandant Batalioni e mjaft detyra të besuara. Shpendi si Oficer i përgatitur sa ushtarakisht dhe moralisht si një nga kuadrot më të talentuar të ushtrisë, i vinte një rëndësi të madhe edukimit atdhetar e kulturor të kursantëve student.

Në vitin 1976 Shpendi kreu studimet në Universitetin e Tiranës dhe u titullua jurist. Por pikërisht në kohën kur për atë mund të hapeshin e çelëshin perspektiva të reja, ai pëson një tronditje të pa pritur nga "vigjëlencia" e Partisë dhe e organeve të sigurimit. Ishte koha e Luftës së klasave që si pjellë e rezistencës të atij sistemi dhe e cilësuar si arma e revolucionit proletar, kontrollonte kashtë e kokërr, zanore e pëshpëritje. Përgjonte këdo, kryesisht kuadro e intelektual të cilës do fushe.

Midis shumë të tjerësh preh e këtij represioni do të ishte i jati Hulësi Topollaj i cili goditet rëndë si bashkëpunëtor i grupit puçist në radhët e ushtrisë, me pseudoargumentin se kishte shkruar dhjetë vjetë më parë një libër për luftën Nacional-Çlirimtare, ku lartësohej figura e heroit të popullit Petrit Dume dhe e drejtuesve të tjerë të kësaj lufte në Kolonjë. Shpendi Topollaj do të atemohej si i jati, me preteksin se ka lexuar librin me kritika letrare të profesor dr. Rexhep Qosja, "Panteoni i rralluar", duke e fajësuar atë me preteksin dhe indetifikimin e fjalës esse me esesët. Pas një sërë masash transferohet me detyrë në një repart të largët. Ai kudo që shkoi, shërbeu e diti të fiton-



te zemrat e efektivëve me mënyrën e mësimdhënies. Krahas atij të artit ushtarak e zgjeronte editorialin e tij mbi librin e letërsisë. Ky alternim i programeve mësimore kishte bërë të dallohej për rezultate të larta në përvetësimin e artit ushtarak popullor nga studentët. Krahas formimit të tij si intelektual, pasioni i tij që libri i stimuluar me bibliotekën e pasur në familje, të atit duke e vlerësuar atë si një ushqim të domosdoshëm shpirtëror.

Pas viteve 90-të Shpendi Topollaj përveç shumë detyrash të tjera pranë këshillit të rrethit, vërshon e të befason me shkrimet e botimet të shumëllojshme në gjinitë letrare, thuajse të të gjitha zhanreve, si romane, tregime, novela, publicistikë, kritika letrare, poezi etj.

Janë të panumërta artikujt e shkruar e botuar nga ai në shtypin e kohës. Shumë libra e krijime të tij janë përkthyer në disa gjuhë të huaja.

Duke mbledhur nektarin e çmuar të urtësisë popullore tek shkrimtari Shpendi Topollaj lindi dhe u rrit më tej dashuria për njerëzit si dhe dashuria për atdheun. Ai nuk rendi si gjithë të tjerët për pasuri; për atë

njëriun e nderuar dhe të shquar nuk e bëjnë as kapitali as titujt që mbanë, por thjeshtësia, jeta e ndershme, dinjiteti dhe veprat në shërbim të vendit.

Autori thekson se leximi është baza e formimit tim, dhe indikator në përkushtimin e krijimtarive letrare të të gjitha gjinive. Më tej jep përkufizimin e egjiptjanëve se "Libri është më i vlefshëm se përmendorja e stolisur me piktura apo gravura, pasi libri ngre përmendoren në zemrën e atij që e lexon".

Në detaje referon se "përvoja në jetë më çoj tek tregimi, novela e romani, dashuria për njerëzit më bëri kritik letrar dhe shpirti i ndjeshëm më bëri poet.

Në të gjithë krijimtarinë time kamë vënë shpirtin veç talentit. Me moton se: "koha ikën nuk kthehet më", autori Topollaj gjen joshjen tek natyralisti Turgenieri se: "Natyra nuk është një tempull, por një punishte ku njëri ka vendin si punëtor". Dhe se jeta në vetvete është shumë e bukur, por atë e shëmtojmë ne me veprimet e këqia, më pasë gëzimi e dhimbja, bukuria e shëmtimi, e mira dhe keqja janë përherë pranë njëra tjetrës. Lufta mes të mirës e të keqes, mes virtytit e vesit është shumë e vjetër, tani ajo ka marë proporcione edhe më shqetësuese. Këtë e tregon fakti se ata që rendin pas pasurimit të pandershëm po shtohen, idealistët dhe humanistët po rrallohen. Pra jeta i ngjan një çfaqjeje, por jo një rëziti e kqinjë të zënë vendet më të mira". Në përmbajtje të veprës letrare të shkrimtarit Shpendi Topollaj dallojmë, së pari, se te tregimi, novela e romani, ai trajton probleme të rëndësishme politike, ekonomike dhe shoqërore. Në ato stigmatizohet me forcë roli i autoriteteve si rregullator në funksion të problematikave ndaj komunitetit.

Së dyti me kritikën letrare, ndikon drejtpërdrejtë si elektrizues i krijim-

tarive të shumë autorëve, kryesisht atyre të rinjë, të cilët i motivon jo vetëm nëpërmjet dashurisë ndaj njerëzimit por dhe me rritjen e ndjenjave mbi artin letrar.

Kritika letrare duhet të luaj rolin e shkencës së letërsisë, me stilin e fjalët e gjetura artistike. Ai zotëron një erudicion që është i domosdoshëm për një kritik letrar.

Është humanizëm edhe t'u analizosh dhe të u tregosh se çfarë mund të ndreqin në të ardhmen shkrimtarët. Sigurisht shkrimtarët me përvojë që do ti pranojnë me kënaqësi ato dhe jo fillestarët që mbi të gjitha kanë nevojë për përkëdhelje. Krijuesit kanë shumë nevojë për t'u vlerësuar e çmuar punën e tyre, heshtja është vrashtar ndaj punës së tyre.

Shkrimtari Shpendi Topollaj me kritikën e tij, kërkon që në hapsirat e letërsisë të pregatisë toka të pasura me humus, të cilat rrisin pemë të mëdha e jo mjedise të varfëra ku rriten vetëm shkurre. Me gjykimin me dashamirësinë e tij, Shpendi inkurajon rritjen e talenteve të reja.

Shkrimtari Shpendi Topollaj, së fundmi vjen me botimin e novelës "Një shëtitje me lugatin". Njëherazi si në krijimtarinë e mëparshme edhe me këtë prurje autori ka arritur të krijojë një vepër që është qëlluar në llojin e saj, e cila për njohësit ka qasje të reales në nuanca metaforike nga e cila gjeneratat në vijim do të huazojnë qëllimin e rëndësishëm të kësaj veprë me lugatin e trilluar. Me diktimin e përmbajtjes së kësaj novele sa historike, autori na bën të qartë se kambanat e ndërjegjes së çthurrur të kohës do të vazhdojnë të dëgjohen gjatë me pasthirmat e kësaj toke të martizuar me periudhën "lugatiane" siç e etikon vet autori. Narracioni i veçantë i letërsisë të shkrimtarit Shpendi Topollaj, tashmë i njohur po i kapërcen gjithnjë e më tepër kufijtë e vendit.

SUPLEMENTI LETRAT

Fatmir Terziu: Ja pse më gëzon fakti i promovimit të librave të shkrimtarit Halil Rama



mi se shkrimtari lindi në një ditë? Pra ai nuk ka ardhur në një ditë. Ai që zgjon duartrokitje në salla, ai që bën miq me shkrime e paraqitje të veçanta, të ralla, nuk është thjesht Halil Rama.

Gjëja e dallueshme e shkrimit për librat e tij, në një gazetë, e duartrokitjeve promovuese me prezencë të madhe intelektuale, është se u drejtohet vetë thelbi i asaj që Rama paraqet, është se u drejtohet vetëm lexuesve të mundshëm. Kjo është arsyeja pse shkrimi i tij është i mirë, madje shumë tërheqës, se shkrimi i mirë kërkon lexues të vërtetë. E këto i ka gjithnjë Halil Rama shkrimtari që gjithnjë shkru-

dhe analizuan në promovimin e librit të 28-të të shkrimtarit dhe publicistit Halil Rama.

Por, unë supozoj se do ta lexoni e rilexoni, gjithsesi me unanimitet të kënaqur, sepse jo më kot Cami shton “në librat e tij, Halil Rama prezantohet si mjeshtër i profilit, duke krijuar personazhe si shembëlltyra që të mbeten në kujtesë.

Tërë publicistika e tij është në një linjë vetëpërbushëse, ku autori me mjeshtëri di të përveçojë protagonistë të veshur me detaje që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshtërisht”.

Mbërthime të tilla janë aspak të lodhshme për ne me gjithë njohshmërinë e tyre. Si mund t'i shikojmë me çudi pas atyre të Borges dhe Calvino, të Pynchon dhe John Barthes, që ta kuptojmë ka mirë penën që shkruan dhe di të seleksionoj kur shkruan. Gjëja e çuditshme për shkrimet e Halil Ramës është se zgjuarsia si kjo duket se do të thotë diçka tjetër, duket se është hedhur në një kontekst të ri, të ndryshëm, të domosdoshëm të njohim atë që ai e përcjell në këtë libër të 28-të të tij. Ka një mish jetik plotë dendësi ekzistenciale në to, dhe të gjithë ata, pra protagonistët e penës së tij, duket se po përpiqen të tërheqin dhe thurin ndonjë rast moral në pëlhurën e njohur dhe të vetëkënaqur postmoderne të shkrimit të Ramës.

Në këtë kuptim, “Dibra dhe dibranët në Panteonin e vlerave” është ironike në një farë mënyre, thellësisht e ndryshme nga ajo e prurjeve të mëparshme të tjerëve. Ironia e tij bie plotësisht jashtë kurthit mashtrues të krahasimit, i cili në një strukturë të re leximi dhe parashtrimi narrativ, madje ngjan në mënyrë kaq të habitshme me një metaforë nga larg, ndërkohë që në mënyrë më tërheqëse mbetet e sinqertë dhe tërheqëse. Kjo është një ironi që lind pikërisht dhe vetëm në nivelin e rrëfimit, dhe në të vetmen mënyrë të mundshme për qëllimin: duke vënë në dukje vazhdimisht pashmangshmërinë e figurativitetit të saj, të rrëfimit; në mënyrë që rrëfimi, në kundërshtim me supozimet këmbëngulëse të rrëfyesit të tij, të mos kthehet te gjuha kohore e alegorisë, por te ndezjet momentale, momentale të kohës së devotshme e të ndjeshme si një kontraktë me atë kohë të dështuar dhe kësaj radhe të shpenguar, dështimet e së cilës hedhin buzëqeshjen nervoze, tepër të tërhequr të ironisë gjithnjë e përsëritur e gjithëpërfshirëse. Duke treguar pamundësinë e ngushëllimit të saj; një kolaps që mohon komoditetin e riprodhimit të përjetshëm në fiktive-iluzore dhe të hedh përsëri dhe përsëri në tmerrin e depërtimit befasues se i ke të dyja këmbët në realitet dhe je dëshpërimisht dhe krejtësisht autentik. Kjo është ironia e realitetit të kërcimshëm dhe megjithatë të pafund të përfshirjes sonë në realitet.

Ironia e “Dibra dhe dibranët në Panteonin e vlerave” është vetë transparencja e saj përfundimtare që lë një shije pafundësie; atë pafundësi me të cilën njerëzit si Kanti i lejojnë vetes të angazhohen: atë pafundësi arti që arti ndonjëherë e lë pas dhe që pafundësia nuk ka të bëjë fare me pafundësinë e artit.

Marrë nga fjalaelire.com, date 15 prill 2025



an shumë, pak flet, dhe të gjitha i tret, sikurse i di vetë.

Këtu më pushton dëshira për të promovuar me vonesë një libër (kohët e fundit e kam parë të zbritur në disa variante analizash dhe kritikash, derisa u duartrokit masivisht dhe në një sallë të madhe, 12 prill 2025 në sallën e kinemasë “Maks Velo” u bë promovimi i librit të tij të fundit) dhe në të njëjtën kohë të flas për të sikur të mos ishte para disa kohësh, por sikur po lexohet dhe duhet rilexuar tashmë. Po mendoja të promovoja, por promovimi i tillë, ra në vështirësi, se për të natyrshëm folën mjaft të tjerë, me shumë vlerë, sikurse më informon shkrimtari Sakip Cami, dhjetra personalitete akademike dhe të letrave morën pjesë, folën

Çfarë mund të nënkuptojë një libër që fillon me një titull të artë: “Dibra dhe dibranët në Panteonin e vlerave”? Ose më mirë, aty kërkohet ari që është shfaqur dhe që duhet festuar publikisht me lexuesit. Ky është një nga ato marifete që ende i ka pllakosur Shekspirin dhe Servantesin dhe mbi të cilin Borges po na përplas kokën në kohën tonë: nëse titulli dallohet duke mos dhënë asnjë shenjë dyshimi se ai është një titull dhe jo një citim, atëherë nga vjen besimi ynë se kemi njerëz të aftë? A nuk i ngjan në mënyrë të qëllim të vetë fakti që ne e mbështesim kaq vazhdimisht një bindje të tillë, të njësuar tek prurjet që na i përcjell shkrimtari Rama në mënyrë reale, me ese, profile dhe ese letrare?

Ja pse më gëzon fakti i promovimit të librave të shkrimtarit, publicistit, gazetarit, kritikut Halil Rama, “Mjeshtër i Madh”, “Qytetar Nderi” i Bulqizës.

Përballë shkrimit dhe vetë librit, sidomos leximit që sot është në një pozitë të vështirë, gjithnjë qëndron një vullnet, një përkushtim, një realitet. Është një realitet që gjithnjë ka një pasqyrë të vetvetes, ka dhe një dëshirë përtej gjendjes. E në të gjitha këto është dhe gëzimi që ndjej për kolegët që botojnë, shkruajnë, promovojnë dhe promovohen. E gjitha është si Fletorja, ajo e dikurshmja që brezi im me kënaqësi dhe estetike e bënte me vijë anash, me një të përthyer të fletës dhe me datë e temë, e me shënimin përcjellës të detyrës. Fletorja, natyrisht, është para meje, por kur shikoj atë që kam shkruar dikur, zhgënjehem kur zbuloj një mangësi të jashtëzakonshme të dhënash rreth fateve të atyre kohërave dhe shkrimeve që shkruanin në kohëra të atilla, që sidoqoftë zhgënjimit më japin dhe thelbin e sotëm të gëzimit, të përcjelljes dhe frymëzimit të shkrimit. E në të gjitha këto është gjithnjë Ai, pra shkrimtari i ditëve të sotme, që kërkon të konkurojë atë të djeshmin, atë ndoshta më të prekshmin.

Sipas shkrimtarit Sakip Cami: “Krijimtaria e tij me poezi dhe reportazhe ka filluar që në moshën 16 vjecare në gazetën “Zëri i Rinisë” dhe “Ushtima e Maleve”. Janë plot 5 dekada krijimtari në publicistikë dhe në gjinitë të tjera letrare. Fjalët e tij, në vend që të marrin forcë nga faktet për t'i riprodhuar ato edhe më dendur dhe më të prekshme, duket se i shpërbëjnë ato vetë për t'u zhdukur plotësisht. ...Të sotmit i shkon mendja se nuk mund të mbështetet më në mënyrat e vjetra të punës. Të dhëna, përgatitje paraprake, kërkime rutinë - këto gjëra nuk luajnë më asnjë rol këtu. Ata thjesht nuk aplikohen.

Por kur përpiqem të mendoj për diçka tjetër, nuk arrij askund. Në këtë pikë, gjithkush mund të thotë vetëm me siguri se çfarë nuk është rasti. Por ajo që është, ajo është ende një mister për mua, pse the-

SUPLEMENTI LETRAT

Libri I 28-të - "DIBRA DHE DIBRAMËT NË PANTEONIN E VLERAVE"

PESHA SPECIFIKE E PERSONAZHEVE TË HALIL RAMËS



në këtë promovim evidentoi rolin e Halil Ramës si shkrimtar e publicist, i cili në këtë vepër (libri i tij i 28-të) ka operuar me parametra historikë, patriotik, estetik, artistik e kumtor dhe ka pëlqyer stilin e ligjërimit publicistik.

Kjo sipas tij për faktin se nëpërmjet një studimi të tillë, të thelluar, autori dritëson ngjarje, bëma dhe një qëndresë epike të mjaft figurave patriotike dibrane si Dine Hoxha filozof popullor; Ahmet Fetah Cami, atdhetari në dy luftëra botërore; Emin Cibaku, dëshmor i rënë në betejën e Kolesjanit; Harun Domi, patriotit që pruri Abetaren në Kalis e Kala të Dodës, Edip Daci, ushtaraku që refuzoi betimin fashist dhe u persekutua nga regjimi komunist, Hamit Koçi, intelektualit patriot i Vajkalit që me gjithë kontributin, u persekutua nga regjimi i diktaturës; Artan Cuku, dëshmor i demokracisë; Adem Islam Hoxha

Dinastia e vëllezërve Keta nga Bulqiza, kampionë bote në kikkoks etj.. Në të njëjtën linjë, edhe gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e vetmja grua shqiptare me këtë gradë madhore, (në këtë veprimtari promovuese mbresëlënëse të moderuar me mjeshtri të rrallë artistike nga regjisori dhe aktori i talentuar Llesh Nikolla - "Mjeshtër i Madh"), vlerësoi shtrirjen në hapësirë dhe kohë të këtij autori, duke sjellë nëpërmjet personazheve fakte dhe ngjarje historike të panjohura, të trevave që ato u përkasin, që nga Kalaja e Dodës, Lura, Zall Dardha, Muhurri, Katër Grykët, Sohodolli, Golloborda, Okshtuni e Bulqiza. "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave" është një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor që ia vlen të lexohet dhe të pasurojë bibliotekat tona. Padyshim që pjesa e portretizimit për një shkrimtar e gazetar është testi i saktë i profesionalizmit

BESIM NDREGJONI

Libri me të njëjtin titull, si i këtij shkrimi, i autorit Halil Rama, që u promovua të shtunën më 12 prill 2025 në prezencën e qindra përfaqësuesve të komunitetit dibran dhe jodibrane në Tiranë, është një enciklopedi me vlera, sepse nëpërmjet jetëshkrimeve të letrarizuara bukur dhe këndshëm të 70 personaliteteve të njohura dibrane, që nga epoka skënderbegiane e deri në ditët e sotme përcjell jehonën e figurave historike që kanë lënë gjurmë në memoriën kombëtare. Personalisht ndjehem i privilegjuar që Halil Rama më ka bërë pjesë të kësaj veprë enciklopedike me 6 kapituj në 446 faqe, si "Emblema e disidencës shqiptare" (titulli i profilit tim në këtë libër), por në këtë shkrim, nuk është kjo ndalesa ime e radhës.

Ashtu si folësit në promovimin e këtij libri, si rektori i Kolegjit Universitar të Biznesit, prof. dr. Ylber Bezo, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, Tatjana Parllaku, prof. dr. Fejzlla Gjabri, studiuesja e letërsisë Emrie Krosi e ndonjë tjetër, dua të evidentoj këtë sipërmarrje të vështirë, plot rreziqe e me risk të Halil Ramës, pasi pesha specifike e personazheve të librit të tij është e madhe. Por, Halil Rama ia ka dalë me sukses si një nga shkrimtarët lëvruar e gërmues, që përtej paragjykimëve e ngjyrave politike, ka vënë në dukje dukuritë më të mira dibrane dhe shqiptare. Veçanërisht dua të falënderoj recensentin e librit, prof. as dr. Bernard Zotaj, që ashtu si në parathënien e shkruar prej tij me dashuri e profesionalizëm, edhe



nga Çidhna, që tregoi heroizëm të pashoq kundra monarko fashistëve grekë në provokacionet e gushtit 1949.

të tij. Këtë test Halil Rama e ka kaluar me sukses, tashmë sepse ashtu si në 28 librat që ka botuar e promovuar, edhe në këtë vepër ai na sjell mjaft personazhe të spikatur, të njohur e të panjohur shumë për publikun e gjerë dibran e jodibrane.

Kufiri kohor që ai ka marrë është të paktën 600 vjet më parë, që nga epoka skënderbegiane, nga e cila studiuesi i zellshëm Fatos Daci na argumenton origjinën dibrane të kryeheroit tonë, Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe Sinën, si vendlindje të tij, e deri te personaliteti i Dine Hoxhës, i njohur si filozofi popullor në oborrin mbretëror. Po ashtu, na befason me përshkrimin brilant të jetës dhe veprës së kompozitorit të madh dibran Muharrem Xhediku etj.. Është gjë e bukur se optika z. Rama përfshin personalitete të moshave e profesioneve të ndryshme si: Edip Daci, Harun Domi, Gani Strazimiri, Hazis Ndreu - Nderi i Kombit, Skënder Cala (ikonë e artit dhe kulturës sonë kombëtare), dr. Sali Kurti, Muharrem Gjoka, Bujar Pata, Osman Miha, Shpëtim Cami, Musa Riçku, Lahim Kola, që të mbeten në mendje me detajet që ai ka dhënë për jetën dhe veprën e tyre. Ndjaj mua s'më mbetet gjë tjetër veçse ta uroj këtë shkrimtar mjaft produktiv e cilësor, të na sjellë kësajsoj libra të tjerë në të ardhmen. /Gazeta Panorama

HALIL RAMA PROMOVON LIBRIN E 28-të

Vijon nga faqja 9

Është një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor që ia vlen të lexohet dhe të pasurojë bibliotekat tona. Padyshim që pjesa e portretizimit për një shkrimtar e gazetar është testi i saktë i profesionalizmit të tij.

Këtë test Halil Rama e ka kaluar me sukses, tashmë me 28 libra të botuar, ashtu si edhe në këtë libër ai na sjell mjaft personazhe të spikatur, të njohur e të panjohur shumë për publikun e gjerë dibran e jodibrane.

Kufiri kohor që ai ka marrë është të paktën 600 vjet më parë, që nga epoka skënderbegiane, nga e cila studiuesi i zellshëm Fatos Daci na argumenton origjinën dibrane të kryeheroit tonë Gjergj Kastriot Skënderbeu dhe Sinën si vendlindje të tij, e deri te personaliteti i Dine Hoxhës i njohur si filozofi pop-

ullor në oborrin mbretëror. Po ashtu na befason me përshkrimin brilant të jetës dhe veprës së kompozitorit të madh dibran Muharrem Xhediku, etj.. Është gjë e bukur se optika z. Rama përfshin personalitete të moshave e profesioneve të ndryshme si: Edip Daci, Gani Strazimiri, Hazis Ndreu, Liri Rasha, Bukurosh Koçi, Dr. Sali Kurti, Muharrem Gjoka, Bujar Pata, Osman Miha, Shpëtim Cami, Musa Riçku, Lahim Kola, që të mbeten në mendje me detajet që ai ka dhënë për jetën dhe veprën e tyre.

Ndjaj mua s'më mbetet gjë tjetër veçse ta uroj këtë shkrimtar mjaft produktiv ecilësor, të na sjell kësajsoj libra të tjerë në të ardhmen.

Në emër të KUB (Kolegjit Universitar të Bisnesit) organizator i këtij aktiviteti së bashku me Njësinë Nr 11 të Bashkisë së Tiramës përshëndeti Prof. Dr.

Vijon në faqen 16

FOTOREPORTAZH



HALIL RAMA PROMOVON LIBRIN E 28-të “DIBRA DHE DIBRANËT NË PANTEONIN E VLERAVE”

(Vijon nga faqja 15)

Ylber Bezo, rektor i Kolegjit Universitar të Biznesit.

Në promovimin e librit “Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave”, emër të OBVL, përshëndeti znj. Tatjana Parllaku, kryetare e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ dhe pasardhësve, e cila vuri në dukje kontributin e zotit H.Rama si kryeredaktor i gazetës “Veterani” si dhe për librin “30 vjet OBVL - histori sukcesi”.

Z. Besim Ndrejoni, President i Unionit Shqiptar të të Përndjekurve Politikë theksoi kontributin e zotit Rama për pasqyrimin e përfaqësuesve të kësaj shtrese të vuajtur të popullit tonë gjatë periudhës së komunizmit.



EMRIE KROSI: KY ËSHTË KULTUROLOGJIKU I GJITHANSHËM HALIL RAMA

Në kuadrin e diskutimit krijues të librit Znj. Emy

KA REALIZUAR 9 DOKUMENTARE TELEVIZIVE:

(si skenarist dhe asistent regjisor)

- **2014** – Një legjendë në kufirin e dy kohëve - në 95-vjetorin e lindjes së Heroit të Popullit Rrahman Parllaku (bashkepunim me RTSH – skenarist dhe as/regjisor)
- **2018** – **Lutfi Ndreu**, mesues dhe artist (bashkepunim me Tv Bulqiza –skenarist dhe as/regjisor)
- **2019** – Gjenerali që sfidoi kohërat (bashkepunim me RTSH – skenarist dhe as/regjisor)
- **2019** – Skender Cala në gjerdanin e artë të kulturës kombëtare (bashkepunim me Tv Bulqiza – skenarist dhe as/regjisor)
- **2020** – Fadil Hoxha – Arkitekti i Kosoves se lire (bashkepunim me RTSH – skenarist dhe as/regjisor) • Setki Jashari, poeti dhe prozatori i dhimbjes njerëzore
- **2023** – Rrahman Parllaku – gjenerali që bëri epokë.
- **AND-ja** e pandryshuar e Shefki Karadakut.
- **Dali Ndreu**, strategu që drejtoi luftën për çlirimin e Tiranës

(Emrie Krosi), një nga zërat më të spikatur të kritikës letrare, vuri në dukje mjeshtërinë artistike të Halilit në realizimin e reportazheve letrare dhe portreteve të njerëzve të thjeshtë e kurajozë.

H. Rama, vazhdon të shkruajë sepse ai përpos shumë titujve, e ka marrë tashmë titullin njeri, nga vetë libri i tij: “Të jesh njeri”. Ky është kulturologjiku i gjithanshëm, Njeriu Halil Rama.

Dr. Fejzulla Gjabri, autor i disa librave, etnolog, u ndal te figurat shquara të muzikës dibrane dhe shqiptare që trajtohen në këtë libër si Muharrem Xhediku, Hazis Ndreu, Lirie Rasha etj. Njëkëtë vëllim gjejmë profile njerëzore, esse, reportazhe letrarë për njerëz të ditur, punëtorë drejtues e krijues. E nis me filozofin popullor Dine Hoxha e luftëtarin Ahmet Camin, Emin Cibakun, dëshmor i rënë në Betejën e Kolesjanit kundër serbëve 1913 e kalon te Harun Domi, që solli nga Bukueshti Abetaren e parë në Kala të Dodës. Libri është bashkëkohor, ku lexuesi njihet me patriotë e luftëtarë që kanë bërë dhe shkruar vetë me vepra historinë .

Në fund autori H.Rama falenderoi të pranishmit. “Kam shkruar 28 libra, por kurrë nuk kam patur emocione si sot. Erdhët me zemër. Nuk është e lehtë në këtë kohë të vështirë të merresh me librin. Folët me zemër.

Edhe unë ju kam në zemër. Me dashuri, larg urretjes do të ecim përpara. Do të përpiqem që sa më shpejt që të jetë e mundur t’ju paraqes vëllimin e dytë me figura dhe vlera të tjera të Dibrës sonë”, tha ndër të tjera auri i kësaj veprë enciklopedike, me 6 kapituj ne 446 faqe..

BOTIME TË AUTORIT HALIL RAMA NË VITE:

- **Dine Hoxha**-Një filozof popullor në Oborin Mbretëror (monografi me b/autor, 2006)
- **Muharrem Xhediku** – Kompozitori i tangos shqiptare (monografi me b/autor, 2008)
- **Fundi i Rrugës së vetme** (refleksione & kritikë letrare , 2011)
- **Testamenti i atdhedashurisë** (Reportazhe, portrete, kritike letrare, 2012)
- **Memoria historike e kombit** (Reportazhe, portrete, kritike letrare, 2013)
- **Rrahman Parllaku**-Një legjendë në kufirin e dy kohëve (monografi me b/autor, 2014)
- **NJEZET VJET OBVL** (Histori, portrete, me b/autor – 2014)
- **Histori brezazh te familjes së shquar Kazazi të Durrësit** (monografi me b/autor, 2015)
- **LIRI BELISHOVA** – Gruaja që sfidoi diktaturën (Monografi – 2016)
- **Në panteonin e vlerave** (refleksione & profile & kritikë letrare, 2016)
- **Bajram Ndreu i Zall Dardhës** (monografi me b/autor, 2017)
- **AGJENDA E NJE MINISTRI** (kushtuar Safet Zhulalit- monografi me b/autor, 2017)
- **Lutfi Ndreu**, mësues dhe artist (Monografi – 2018)
- **Rizgime meteorësh** (refleksione ; profile ; kritikë letrare ; Poezi, - 2018)
- **Skender Cala në gjerdanin e artë të kulturës shqiptare** (Monografi letrare ,2019)
- **Gjenerali që sfidoi kohërat** (monografi me b/autor, 2019)
- **MUHURRI-Histori dhe personalitete** (Monografi-2020)
- **Fluturon shqipja mbi Korab** (Reportazhe, portrete, kritike letrare, 2021)
- **Zall Dardha në ditarin e Isuf Rashës** (Monografi me b/autor S.Cami-2021)
- **Magjia e fjalës** (Refleksione, kritike letrare -2021)
- **Ekzaminimi i diktaturës në vepra letrare** (Reportazhe, portrete, kritike letrare, 2022)
- **AND-ja e pandryshuar e Shefki Karadakut** (monografi letrare -2023)
- **Rilindja e emrave** (Refleksione, kritike letrare) (2023)
- **Të fitosh titullin NJERI** (Refleksione, kritike letrare, 2023).
- **30 vjet OBVL** – Histori sukcesi (Monografi-2024)
- **Zëra bashkëkohorë** (Profile&; Kritika letrare – 2024)
- **40 vepra letrare të 40 autorëve në skaner – 2024.**